

LËVIZJA RINORE EGJIPTIANE DHE ROME



FUQIZIMI DHE PËRFSHIRJA E KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË VENDIMMARRJEN LOKALE

**RAPORT STUDIMOR,
RAPORT MONITORIMI DHE PRAKTIKAT E MIRA**

ELBASAN, SHKURT 2026



Ky raport u realizua në kuadër të projektit “Zëri i Komunitetit: Fuqizimi i Romëve dhe Egjiptianëve për Vendimmarrje Lokale” zbatuar nga Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome me mbështetjen e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).

AUTOR: © LËVIZJA RINORE EGJIPTIANE DHE ROME, SHKURT 2026

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Ky publikim, është mundësuar me mbështetjen financiare të ASHMC-së. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit, opinioni i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i ASHMC-së.

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtimeve5

Lista e grafikëve.....5

I | **HYRJE**6

II | **RAPORT STUDIMOR**7

1. **HYRJE**

II.1.1 Qëllimi i studimit7
II.1.2 Konteksti: Buxheti me Pjesëmarrje në Shqipëri dhe Elbasan7

2. **METODOLOGJIA**

II.2.1 Objektivi9
II.2.2 Struktura e pyetësorit9
II. 2.3 Popullata dhe kampioni10
II. 2.4 Kufizimet e mundshme të të dhënave10
II. 2.5 Profili i të anketuarve10
 II.2.5.1 Moshë10
 II.2.5.2 Gjinia11
 II.2.5.3 Niveli arsimor12
 II.2.5.4 Statusi i punësimit12
 II. 2.5.5 Madhësia e familjes13
II. 2.6 Etika dhe mbrojtja e të dhënave14
II. 2.7 Interpretimi dhe raportimi14

3. **REZULTATET**

II.3.1 Njohuri të përgjithshme14
II.3.2 Përfshirja konkrete18
II.3.3 Nevojat e banorëve përballë bashkisë22

4. II.4 Diskutim dhe analizë e rezultateve27

5. II.5 Rekomandime29

6. II.6 Referencat32

KREU III. RAPORT MONITORIMI

III

III. 1. Hyrje: Panorama e përgjithshme e qeverisjes vendore.....	33
III. 2. Kuadri ligjor dhe institucional: Baza e monitorimit.....	33
III. 3. Gjetjet e monitorimit: Hendeku midis ligjit dhe realitetit.....	34
III. 4. Rekomandime strategjike për përmirësimin e procesit.....	37
III. 5. Përfundime.....	38

KREU IV. 12 PRAKTIKA TË MIRA PËR PËRFSHIRJE DHE ADVOKIM KOMUNITAR NË LAGJEN “RRAPISHTË”, ELBASAN

IV

1. Praktika 1: Qasje e strukturuar për informim dhe ndërgjegjësim qytetar.....	41
2. Praktika 2: Krijimi dhe fuqizimi i Grupit të Advokimit Komunitar	42
3. Praktika 3: Hartimi, pilotimi dhe plotësimi i pyetësorit	44
4. Praktika 4: Dokumentimi i kërkesave prioritare.....	45
5. Praktika 5: Aktivizimi i Grupit Komunitar për pjesëmarrje efektive në buxhetimin me pjesëmarrje	46
6. Praktika 6: Forcimi i komunikimit institucional.....	47
7. Praktika 7: Advokimi si mjet ndikimi në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak.....	47
8. Praktika 8: Përdorimi i peticionit si mekanizëm ligjor për të ndikuar në vendimmarrje	48
9. Praktika 9: Lobimi si mjet për ndikim në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak.....	49
10. Praktika 10: Mekanizmi i dialogut të vazhdueshëm për llogaridhënie dhe transparencë	50
11. Praktika 11: Takim teknik për implementimin e prioriteteve të komunitetit me përfaqësuesit e bashkisë	51
12. Praktika 12: Përdorimi i multimedias dhe rrjeteve sociale si mjet për ndërgjegjësim publik dhe presion pozitiv	51
13. Konkluzion.....	53

V

KREU V. REKOMANDIME55

LISTA E SHKURTIMEVE

BP – Buxhetimi me Pjesëmarrje
GAK- Grupi i Advokimit Komunitar
KB - Këshilli Bashkiak
LRER - Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome
NJVV – Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OJF- Organizata Jofitimprurëse
OJQ - Organizata Joqeveritare
PAK - Pagesa e aftësisë së kufizuar
VKB - Vendim i Këshillit Bashkiak

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1: Mosha	11
Grafiku 2: Gjinia	11
Grafiku 3: Niveli arsimor.....	12
Grafiku 4: Statusi i punësimit të të anketuarve	13
Grafiku 5: Madhësia e familjes	14
Grafiku 6: Njohuritë mbi investimet e bashkisë.....	15
Grafiku 7: Dëgjimi i zërit të komunitetit nga bashkia	16
Grafiku 8: Pjesëmarrja në takime të organizuara nga bashkia	17
Grafiku 9: Pengesat për të marrë pjesë në takimet e organizuara nga bashkia	19
Grafiku 10: Bashkëpunimi mes bashkisë dhe OJF-ve	20
Grafiku 11: A ke dëgjuar ti të ketë ardhur stafi i bashkisë në lagjen tuaj për të folur mbi buxhetin?	21
Grafiku 12: Me sa di ti, a ka ardhur stafi i bashkisë të japë llogari për buxheti.....	22
Grafiku 13: Sipas mendimit tuaj, cili është shërbimi publik më urgjent që duhet përmirësuar nga bashkia?.....	24
Grafiku 14: Sa të kënaqur jeni me shërbimet aktuale të bashkisë në lagjen tuaj?.....	25

KREU I. HYRJE

Pjesëmarrja aktive e qytetarëve në vendimmarrjen lokale është themeli i një qeverisjeje demokratike, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse. Në Shqipëri, procesi i decentralizimit ka krijuar hapësira të reja që qytetarët të mos jenë thjesht përfitues pasivë të shërbimeve në nivel lokal, por të bëhen aktorë kyç në përcaktimin e prioriteteve të investimeve lokale. Aktualisht, sfida e decentralizimit në kontekstin shqiptar nuk qëndron vetëm te transferimi i kompetencave drejt bashkive, por te garancia që zëri i çdo qytetari, pavarësisht përkatësisë sociale apo etnike, të dëgjohet në proceset e alokimit të fondeve publike. Buxhetimi me Pjesëmarrje (BP) shërben pikërisht si urë lidhëse mes nevojave të komunitetit dhe politikave vendore.

Ky dokument është hartuar me fokus specifik në Bashkinë e Elbasanit dhe, më konkretisht, në dinamikën e lagjes "5 Maji" (zona Rrapishtë). Përzgjedhja e kësaj zone nuk është e rastësishme; ajo përfaqëson një komunitet që, ndonëse përballet me sfida të shumta socio-ekonomike dhe infrastrukturore, mbart një potencial të madh për t'u organizuar dhe për të kërkuar të drejtat e veta. Dokumenti vjen si rezultat i një iniciative për të fuqizuar zërin e këtij komuniteti, duke synuar të paraqesë të dhëna konkrete dhe argumente të faktuara si për qytetarët, edhe për autoritetet vendore.

Në thelb, ky dokument synon të shërbejë si një udhërrëfyes për të kaluar nga marginalizimi drejt pjesëmarrjes aktive, duke vendosur qytetarin në qendër të qeverisjes vendore, përmes dialogut të strukturuar dhe efektiv me autoritetet vendore. Struktura e këtij raporti është organizuar në mënyrë logjike për të ofruar një analizë të plotë, nga vlerësimi i situatës deri te zgjidhjet konkrete.

Kreu II (Raport Studimor) analizon perceptimet dhe përvojat e banorëve të Rrapishtës. Ai mat nivelin e njohurive mbi buxhetimin, identifikon barrierat që pengojnë pjesëmarrjen e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, dhe evidenton prioritetet e tyre reale.

Kreu III (Raport Monitorimi) ofron një vështrim të drejtpërdrejtë mbi gjendjen aktuale të shërbimeve publike në lagje, duke dokumentuar hendekun midis detyrimeve institucionale dhe realitetit në terren, me qëllimin final përmirësimin e cilësisë së jetesës në lagjen "5 Maji".

Kreu IV (Praktikat e Mira) sjell shembuj pozitivë të angazhimit qytetar që janë realizuar në kuadër të këtij projekti dhe që mund të replikohen edhe në kontekste të tjera të ngjashme.

Kreu V (Rekomandime) përmbyll dokumentin me rekomandime për bashkinë dhe komunitetin me objektiv të përbashkët: rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrjen lokale, duke u mbështetur në të dhënat dhe në vlerat e drejtësisë sociale dhe të barazisë.

KREU II. RAPORT STUDIMOR

I. HYRJE

1.1 Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij studimi është të mbledhë dhe të analizojë perceptimet, përvojat dhe prioritetet e komunitetit në lagjen “Rrapishtë” në Elbasan. Fokusi kryesor është pjesëmarrja qytetare në proceset e qeverisjes vendore, me vëmendje të veçantë kushtuar buxhetimit lokal, cilësisë së shërbimeve publike dhe dialogut me autoritetet vendore. Studimi synon të kontribuojë në fuqizimin e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane duke identifikuar nevojat kryesore, barrierat në pjesëmarrje dhe mundësitë për përmirësimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe transparencës.

1.2 Konteksti: Buxhetimi me Pjesëmarrje në Shqipëri dhe Elbasan

Përpyqjet për të rritur transparencën dhe llogaridhënien në financat publike në Shqipëri janë lidhur ngushtë, për gati dy dekada, me konceptin e buxhetimit me pjesëmarrje. Ndonëse ky model e ka gjenezën në suksesin e Porto Alegre-s në Brazil gjatë viteve 1990-2000 (Santos, 1998), në kontekstin shqiptar ai u prezantua si një instrument strategjik për të tejkaluar hendekun e thellë të besimit midis qytetarëve dhe qeverisjes vendore pas tranzicionit postkomunist.

Implementimi i praktikave të para të buxhetimit me pjesëmarrje në Shqipëri filloi të konsolidohej rreth vitit 2005, si një iniciativë pioniere e drejtuar nga Instituti i Kërkimeve Urbane (URI), me mbështetjen financiare dhe teknike të donatorëve strategjikë si Banka Botërore (Urban Research Institute [URI], 2005).

Qëllimi fillestar i këtyre ndërhyrjeve nuk ishte thjesht konsultimi sipërfaqësor, por krijimi i një kulture të re institucionale. Gjatë periudhës 2007–2009, bashkëpunimi i aktorëve lokalë me Partneritetin Ndërkombëtar të Buxhetit mundësoi vlerësimin e parë serioz të transparencës fiskale, duke e futur Shqipërinë në hartën e Indeksit të Buxhetit të Hapur (International Budget Partnership [IBP], 2008). Përvoja e fituar në disa bashki pilot çoi në formalizimin e procesit përmes hartimit të paketave metodologjike për zyrtarët lokalë, duke hedhur themelet për standardizimin e konsultimeve publike në nivel kombëtar.

Në këtë kuadër kombëtar, Bashkia e Elbasanit zë një pozicion të veçantë, duke u shfaqur si pararendëse e këtyre proceseve edhe përpara se ato të konsolidoheshin si praktika të zakonshme në nivel kombëtar. Dokumentet arkivore dhe studimet krahasuese rajonale konfirmojnë se Elbasani ka qenë një nga bashkitë e para që ka filluar buxhetimin me pjesëmarrje që nga viti 2004. Sipas një studimi të Qendrës për Zhvillimin e OJQ-ve (CRNVO) mbi praktikën në Malin e Zi dhe Shqipëri, Elbasani, me mbështetjen e UN Women, krijoi precedentin e bashkëpunimit midis sektorit civil dhe administratës lokale në një kohë kur koncepti ishte ende i panjohur për shumicën e bashkive shqiptare (CRNVO, 2013).

Në vitet që pasuan, një rol kyç në konsolidimin e këtyre proceseve luajti Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, e cila mbështeti Bashkinë e Elbasanit në konceptimin e dëgjësave publike jo vetëm si një detyrim ligjor, por si hapësira funksionale për diskutimin dhe prioritizimin e investimeve publike (OSCE, 2014). Përmes kësaj mbështetjeje, OSBE kontribuoi në forcimin e kapaciteteve

administrative të bashkisë për menaxhimin e procesit të konsultimit në një shkallë më të gjerë, duke krijuar një bazë institucionale më të qëndrueshme.

Në vitin 2012, Bashkia e Elbasanit, e ndërgjegjshme për nivelin e ulët të pjesëmarrjes së grave në proceset vendimmarrëse, nisi zbatimin e Buxhetimit me Pjesëmarrje me Balancë Gjimore. Sipas udhëzuesit të Këshillit të Evropës që referon Elbasanin si shembull të praktikave të mira, kjo nismë u realizua përmes një bashkëpunimi të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile dhe median, dhe u mbështet nga trajnime të posaçme për zyrtarët publikë, të fokusuara në forcimin e aftësive lehtësuese dhe në nxitjen e mbledhjes së komenteve dhe propozimeve nga gratë në lagje dhe fshatra (Këshilli i Evropës, 2018, fq. 42-43).

Tradita e hershme e buxhetimit me pjesëmarrje e Bashkisë së Elbasanit shërbeu si një bazë e rëndësishme për zgjerimin gradual të përfshirjes qytetare drejt grupeve të marginalizuara. Në këtë proces, organizata Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome (LRER) ka luajtur një rol të rëndësishëm si aktor komunitar dhe si urë lidhëse ndërmjet komunitetit, përfshirë zonën e Rrapishtës, dhe institucioneve vendore. Përmes advokimit dhe mobilizimit komunitar, LRER ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe në artikullimin e nevojave prioritare të banorëve.

Krahas kësaj, Bashkia Elbasan ka ndërtuar një kuadër të formalizuar politikash vendore që synojnë përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen qytetare. Ndër dokumentet strategjike të rëndësishme përfshihen Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022 dhe Plani Vendor i Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025–2028. Ky i fundit synon forcimin e mekanizmave të mbrojtjes sociale, identifikimin e grupeve në nevojë dhe përmirësimin e aksesit në shërbime, duke e konsideruar pjesëmarrjen e komuniteteve lokale dhe konsultimin publik si elemente thelbësore të planifikimit dhe zbatimit të politikave sociale në nivel vendor.

Ekzistenca e këtyre planeve krijon një kornizë të favorshme institucionale për monitorimin e përfshirjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane në vendimmarrjen lokale dhe në proceset buxhetore, veçanërisht kur mekanizmat formalë të konsultimit shoqërohen me përfaqësim real, dokumentim të kontributeve dhe reflektim të tyre në alokimin e burimeve publike.

Lagjja “Rrapishtë” në Elbasan banohet nga një komunitet me një përqindje të lartë të anëtarëve Romë dhe Egjiptianë, me rreth 2372 banorë (rreth 539 familje). Madhësia e familjes sipas censusit është 4.4 anëtarë (Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, 2014). Shumica e banorëve jetojnë në kushte të vështira ekonomike, me të ardhura të ulëta, dhe një pjesë e mirë mbështeten në skemat e përkrahjes sociale, ndihmës ekonomike ose në punën informale. Megjithatë ndodhet brenda hapësirës urbane, zona konsiderohet informale dhe karakterizohet nga mungesa e investimeve publike dhe shërbimeve bazë, përfshirë rrugët e paasfaltuara, mungesën e ndriçimit publik, kanalizimet jo plotësisht funksionale dhe infrastrukturën e dëmtuar. Përgjashtimi social dhe ekonomik i banorëve të kësaj zone, së bashku me mungesën e mekanizmave efektivë të përfshirjes qytetare, kanë rezultuar në pjesëmarrje të kufizuar në proceset vendimmarrëse në nivel vendor.

Nga kontaktet dhe puna e vazhdueshme në terren nga organizata LRER, rezulton se banorët shpesh nuk kanë informacion mbi të drejtat e tyre, shpesh nuk marrin pjesë në konsultime publike dhe kanë vështirësi për të artikuluar prioritetet e tyre përballë autoriteteve vendore. Në këtë kontekst, forcimi i kapaciteteve komunitare dhe krijimi i një komunikimi të qëndrueshëm

midis banorëve dhe bashkisë paraqitet si një nevojë jashtëzakonisht e rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së jetesës në zonë.

Në këtë raport, ne do të shqyrtojmë mënyrat se si komuniteti e vlerëson pjesëmarrjen në vendimmarrje, cilat janë pengesat kyçe dhe cilat janë mundësitë për një qasje më gjithëpërfshirëse të llogaridhënies në qeverisjen lokale.

2. Metodologjia

2.1 Objektivi

Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë një kuadër të qartë për perceptimet, përvojat dhe nevojat e komunitetit Rom dhe Egjiptian në lagjen Rrapishtë të Elbasanit. Ky kuadër synon të ndihmojë në vlerësimin e përfshirjes së tyre në proceset e qeverisjes vendore dhe në vlerësimin e prioriteteve për buxhetimin lokal, cilësinë e shërbimeve publike dhe dialogun me institucionet. Metodologjia mbështetet në mbledhjen e të dhënave cilësore dhe sasiore përmes një pyetësoi të strukturuar, i ndarë në katër blloqe përmbajtësore, me një analizë të thelluar të profilit demografik të të anketuarve. Qëllimi i pyetësoit është të sigurojë një dokumentim të qëndrimeve dhe nevojave të komunitetit. Për më tepër, ky raport synon të shërbejë si burim informacioni si për qytetarët, edhe për autoritetet vendore, duke forcuar artikulin e prioriteteve të komunitetit në raport me pushtetin lokal dhe duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies institucionale.

2.2 Struktura e pyetësoit

Pyetësoi u organizua në katër blloqe përmbajtësore, të rëndësishme për të mbuluar dimensionet kyçe të realitetit në komunitet: (A) të dhënat demografike; (B) njohuri mbi përfshirjen e komunitetit në qeverisjen vendore; (C) niveli i përfshirjes konkrete dhe bashkëpunimi me institucionet; dhe (D) nevojat dhe prioritetet e komunitetit. Çdo bllok përmbajtësor përbëhet nga një seri pyetjesh të strukturuar qartë, të hartuara për të nxjerrë të dhëna të vlefshme për planifikimin, advokimin dhe monitorimin e realizimit të shërbimeve publike dhe të proceseve vendimmarrëse në nivel vendor.

Pyetësoi përbëhet nga një kombinim i pyetjeve të mbyllura dhe të hapura, të cilat janë hartuar me qëllim që të evidentojnë perceptimet e banorëve të Lagjes Rrapishtë ndaj nivelit të pjesëmarrjes qytetare, barrierat që pengojnë angazhimin, dhe pritshmëritë e qytetarëve ndaj mekanizmave të llogaridhënies dhe transparencës. Gjithashtu, pyetjet kanë synim të identifikojnë barrierat kulturore, ekonomike dhe administrative që mund të ndikojnë në pjesëmarrjen qytetare dhe në qasjen në shërbime publike.

Para aplikimit në terren, pyetësoi iu nënshtrua një faze pilotimi me një grup prej 15 banorësh të komunitetit, me qëllim testimin e qartësisë së pyetjeve, kuptueshmërinë e tyre nga të anketuarit, vlerësimin e kohës së nevojshme për plotësim dhe verifikimin e përshtatshmërisë kulturore dhe gjuhësore të instrumentit. Gjetjet nga pilotimi kontribuan në riformulimin e disa pyetjeve, thjeshtësimin e disa termave, dhe në përmirësimin e strukturës së përgjithshme të pyetësoit, duke rritur vlefshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave të mbledhura.

2.3 Popullata dhe kampioni

Përzgjedhja e të anketuarve u realizua me qëllim që të përfaqësonte një spektër të gjerë të moshës, gjinisë, arsimit dhe statusit të punësimit brenda komunitetit në lagjen Rrapishtë. Shifrat e pyetësorëve të realizuar arritën në 167 individë, duke përfaqësuar një nivel të përgjithshëm të banorëve dhe një mbulim të kënaqshëm të familjeve të zonës. Përzgjedhja u synua të mundësonte pjesëmarrje të gjerë dhe të shmangte grumbullimin e të dhënave që mund të lindin nga një kampion i kufizuar. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet që pjesëmarrja mund të jetë deri diku e kufizuar për disa segmente të marginalizuar të komunitetit, të cilët mund të mos kenë pasur qasje të njëjtë në procesin e anketimit ose mund të mos kenë të njëjtin nivel të informacionit për të shprehur pikëpamjet e tyre. Ndonjëherë, ky kufizim mund të ndikojë në mospërfaqësimin e plotë të të gjithë zërave në komunitet. Në faza të ardhshme të hulumtimit mund të synohet zbutja e këtij kufizimi përmes komunikimit më të fokusuar dhe të aksesueshëm.


2.4 Kufizimet e mundshme të të dhënave

Bazuar në natyrën e mbledhjes së të dhënave përmes një pyetësi të strukturuar në formular google, të dhënat bazohen kryesisht në vetë-raportim nga ana e banorëve dhe regjistrim nga intervistues terreni. Ky fakt mund të sjellë sfida të ndryshme, duke përfshirë perceptime subjektive, interpretime të ndryshme të terminologjive dhe mundësinë e të dhënave të deformuara nga tendencat ose nga bashkëshoqërimi i përgjigjeve. Gjithashtu, mund të ekzistojë një vështirësi e përfaqësimit të plotë të të gjitha segmenteve të komunitetit, duke përfshirë ata që janë më të marginalizuar ose që kanë qasje të kufizuar në mënyra të komunikimit. Megjithatë, në këtë raport studimor nuk synohet të kryhet një analizë statistikore e mirëfilltë në këtë fazë. Qëllimi është të ofrohet një panoramë e qartë e bazuar njëkohësisht në të dhëna cilësore dhe sasiore mbi qëndrimet, nevojat dhe prioritetet e komunitetit. Për të adresuar këto kufizime, do të sugjerohen hapa të tjerë të hulumtimit në të ardhmen që mund të përfshijnë kampion të përmirësuar dhe analiza më të hollësishme.

2.5 Profili i të anketuarve

2.5.1 Moshë


Analiza demografike e moshës tregon një përbërje të gjerë, me një përqendrim të lartë të të anketuarve në grupmoshën 36–45 vjeç (44 persona, rreth 26.3%). Grupmosha 26–35 vjeç dhe 18–25 vjeç përbëjnë 20.4% dhe 19.2% të kampionit përkatësisht, duke reflektuar një pjesëmarrje të konsiderueshme të brezave të rinj në procesin e diskutimit të çështjeve komunitare. Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve i përket moshës 46–55 vjeç (19 persona, rreth 11.4%) dhe 56–65 vjeç (23 persona, rreth 13.8%), të cilët shpesh kanë rol të rëndësishëm në komunitet si figura referimi, por mund të kenë kufizime në pjesëmarrje për shkak të kushteve shëndetësore apo angazhimeve familjare. Ky lloj përqendrimi demografik siguron një pasqyrë të gjerë të nevojave dhe perspektivave të komunitetit, dhe mundëson një vlerësim të gjerë të prioriteteve të tyre në një spektër të gjerë të moshave.



Grafiku 1: Mosha

2.5.2 Gjinia


Nga gjithsej 167 të anketuar, ndarja sipas gjinisë tregon një përfaqësim të balancuar midis meshkujve dhe femrave. Në total, 89 meshkuj (53%) dhe 78 femra (47%) kanë marrë pjesë në studim, duke u dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve të pyetësorit. Kjo shpërndarje relativisht e barabartë mes burrave dhe grave të përfshirë në studim është e rëndësishme për analizën e gjetjeve, pasi mundëson marrjen në konsideratë të perspektivave të ndryshme gjinore, sidomos në një komunitet ku rolet tradicionale, sfidat sociale dhe qasja në shërbime publike mund të ndryshojnë midis burrave dhe grave. Përfshirja e konsiderueshme e grave tregon gatishmëri për të kontribuar në këtë proces, pavarësisht pengesave të mundshme të lidhura me kohën, angazhimet familjare ose qasjen në informacion. Ky ekuilibër gjinor e rrit besueshmërinë e të dhënave dhe siguron që rekomandimet e raportit të bazohen në një panoramë gjithëpërfshirëse të nevojave dhe prioritetëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në lagjen Rrapishtë, Elbasan.



Grafiku 2: Gjinia

2.5.3 Niveli arsimor

Të dhënat mbi nivelin arsimor të të anketuarve tregojnë një prirje drejt niveleve të ulëta të shkollimit. Nga gjithsej 167 pjesëmarrës, 90 persona deklarojnë se nuk kanë përfunduar asnjë nivel shkollimi, duke përbërë pothuajse 54% të kampionit. Kjo është një gjetje kritike që tregon për mungesën e qasjes në arsim, një faktor që lidhet ngushtësisht me kufizime sociale, ekonomike dhe kulturore. Një pjesë tjetër e konsiderueshme, 49 të anketuar (rreth 29%), kanë përfunduar shkollën fillore, ndërsa vetëm 19 persona (11%) kanë përfunduar shkollën 9-vjeçare. Përtej këtij niveli, vetëm 7 persona kanë përfunduar shkollën e mesme, vetëm 1 person ka arritur nivel universitar dhe 1 person ka deklaruar se ka ndjekur studimet e nivelit master. Kjo shpërndarje pasqyron një realitet të lidhur me situatën arsimore tek komuniteti Rom dhe Egjiptian në lagjen Rrapishtë. Mungesa e arsimit jo vetëm që ndikon në mundësitë e punësimit dhe në mirëqenien ekonomike, por edhe në aftësinë për t'u përfshirë në mënyrë aktive në proceset e vendimmarrjes, pjesëmarrjen qytetare, dhe qasjen në shërbime publike. Prandaj, rezultatet nënvizojnë nevojën për ndërhyrje të synuara që mbështesin rikthimin në arsim, programe dhe nisma për parandalimin e braktisjes shkollore.




Grafiku 3: Niveli arsimor

2.5.4 Statusi i punësimit

Të dhënat e mbledhura tregojnë një shkallë të lartë të papunësisë dhe mbështetjes në skemat sociale brenda komunitetit Rom dhe Egjiptian në lagjen Rrapishtë. Nga 167 të anketuar, vetëm një pjesë e vogël e tyre është e përfshirë në tregun formal të punës. Rezulton se 71 persona marrin ndihmë ekonomike, duke e bërë këtë kategorinë më të madhe, me 42.5% të deklaruar përmes pyetësorit si përfitues të ndihmës ekonomike.

Po ashtu, 42 të anketuar identifikohen si të papunë (25.1%), ndërsa 19 persona (11.4%) kanë deklaruar se përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar (PAK), çka tregon prani të vështirësive shëndetësore ose paaftësive që ndikojnë në mundësitë për punësim. Përfshirja në punësim është e


ulët, me vetëm 21 persona (12.6%) që raportojnë se janë të punësuar dhe 11 persona (6.6%) të vetëpunësuar. Edhe pse ky fakt nuk është deklaruar në përgjigjet e pyetësorit, shpesh ekziston edhe realiteti i punësimit informal ose vetë-punësimit nga ana e pakicave romë dhe egjiptiane në tregun e veshjeve të përdorura. Ndërkohë, kategoria e studentëve rezulton me 0 përgjigje, ndërsa vetëm 3 persona (1.8%) janë regjistruar si punëkërkuar aktivë. Këto të dhëna reflektojnë një realitet social-ekonomik të vështirë, ku një pjesë e madhe e komunitetit varet nga skemat e mbështetjes sociale dhe përballet me pengesa të mëdha në arritjen e punësimit.



Grafiku 4: Statusi i punësimit të të anketuarve

2.5.5 Madhësia e familjes

Të dhënat mbi madhësinë e familjes ofrojnë një panoramë të qartë të strukturës familjare në komunitetin Rom dhe Egjiptian në lagjen Rrapishtë. Nga 167 të anketuarit, shumica deklarojnë se jetojnë në familje me 3–5 anëtarë, duke reflektuar një model tipik të familjeve me madhësi mesatare. Bazuar në shpërndarjen sipas numrit të anëtarëve të familjes, rezultatet tregojnë se familjet me 3, 4 dhe 5 anëtarë përbëjnë bërthamën kryesore të komunitetit, me gjithsej 101 familje, ose 60% të të anketuarve. Ndërkohë, familjet me 6 ose më shumë anëtarë përfaqësojnë mbi 19% të kampionit të studimit, duke evidentuar një realitet që ka nevojë më të theksuara në banim, qasje në shërbime dhe mbështetje sociale. Vetëm një numër i vogël familjesh (5%) kanë raportuar se përbëhen nga 1 anëtar, çka mund të jetë tregues për situata lehtësisht të cenueshme, veçanërisht për të moshuarit ose individët pa mbështetje familjare.



Grafiku 5: Madhësia e familjes

2.6 Etika dhe mbrojtja e të dhënave

Të gjitha të dhënat e grumbulluara në kuadër të këtij raporti studimor janë mbledhur në përputhje me standardet etike dhe konfidencialitetin e të intervistuarve. Të dhënat janë anonimizuar për të garantuar privatësinë e pjesëmarrësve. Menaxhimi i të dhënave, përdorimi i tyre dhe shpërndarja e rezultateve janë të qarta dhe të mbrojtura nga keqpërdorimet.


2.7 Interpretimi dhe raportimi

Në këtë fazë të raportimit, të dhënat paraqiten kryesisht në mënyrë përshkruese dhe ilustruese, duke theksuar trendet, përfaqësimin demografik dhe çështjet kyçe të perceptuara nga të anketuarit. Qëllimi i raportimit është të evidentojë qëndrimet dhe nevojat e komunitetit, të paraqitura në mënyrë të qartë dhe të ilustruar njëkohësisht përmes tabelave, shifrave dhe diskutimeve analitike. Gjithashtu, ofrohen rekomandime për hulumtime në të ardhmen dhe për të shtuar efektivitetin e qasjes ndaj proceseve vendimmarrëse.

3. Rezultatet

3.1 Njohuri të përgjithshme mbi përfshirjen e komunitetit në qeverisjen vendore.

Lidhur me perceptimin e banorëve mbi investimet e bashkisë në lagjen Rrapishtë, të dhënat e raportuara nga pyetësorët tregojnë se shumica dërrmuese e të anketuarve mendojnë se bashkia nuk ka investuar aspak në lagjen Rrapishtë. Konkretisht, nga 167 pjesëmarrës, 117 persona (rreth 70%) deklarojnë se bashkia nuk ka investuar aspak. Nga ana tjetër, 17 persona (rreth 10%) mendojnë se bashkia ka investuar pak në lagjen e tyre. Ndërkohë, 33 persona (rreth 20%) shprehen se kanë njohuri që investimet e bashkisë në lagjen Rrapishtë janë realizuar deri diku.




Grafiku 6: Njohuritë mbi investimet e bashkisë

Bazuar në të dhënat e pyetësorëve për këtë pyetje, asnjë person nuk ka zgjedhur opsionin shumë sa i përket njohurive të përgjithshme që ata kanë mbi investimet e bashkisë në lagjen e tyre. Ky rezultat tregon një perceptim të mungesës së mbështetjes institucionale nga ana e banorëve, duke reflektuar distancë të ndjeshme mes komunitetit dhe bashkisë. Nga njëra anë, niveli i ulët i informacionit dhe transparencës mund të jetë një faktor shpjegues për shkaqet e këtij perceptimi. Nga ana tjetër, edhe mungesa reale e investimeve në infrastrukturë dhe shërbime mund të shpjegojë deri diku perceptimin e banorëve.

Këto gjetje nënvizojnë nevojën që bashkia të rrisë komunikimin me komunitetin, të përmirësojë transparencën mbi projektet, të angazhojë banorët në planifikimin e monitorimin e investimeve si edhe të ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin e kushteve të jetesës për pakicat rome dhe egjiptiane në veçanti, dhe për të gjithë qytetarët e Bashkisë Elbasan, në përgjithësi.

Njëkohësisht, të dhënat tregojnë se komuniteti Rom dhe Egjiptian në lagjen Rrapishtë ka një perceptim shumë të ulët mbi nivelin e dëgjimit të zërit të tyre nga bashkia. Nga të anketuarit, pothuajse askush nuk mendon se zëri i komunitetit dëgjohej “shumë”, ndërsa vetëm një përqindje shumë e vogël prej 17 personash (10.2%) mendojnë se ai dëgjohej “deri diku”. Ndërkohë, 15 të anketuar të tjerë (9%) janë shprehur se zëri i komunitetit dëgjohej “pak”.




Grafiku 7: Dëgjimi i zërit të komunitetit nga bashkia

Shqetësues mbetet fakti që 135 persona (80.8%), pra shumica dërrmuese, besojnë se zëri i komunitetit nuk dëgjohet fare nga bashkia. Ky fakt tregon se pakicat rome dhe egjiptiane perceptojnë se ekziston një distancë e madhe komunikimi midis institucioneve vendore dhe banorëve të zonës, si edhe një mungesë besimi në mekanizmat e përfshirjes qytetare. Këto rezultate sugjerojnë se qytetarët nuk e shohin veten si pjesë të proceseve vendimmarrëse dhe nuk ndihen të përfaqësuar apo të marrë në konsideratë nga bashkia. Ky perceptim mund të lidhet me mungesë informacioni, komunikim të dobët mes palëve, apo mungesë takimesh dhe konsultimesh të rregullta në lagje. Në përgjithësi, këto të dhëna sinjalizojnë nevojën e menjëhershme për rritjen e transparencës, dialogut dhe kanaleve efektive të komunikimit midis bashkisë dhe komunitetit Rom dhe Egjiptian në lagjen Rrapishtë.

Vetëm një nga pjesëmarrësit në studim theksoi se zëri i komunitetit është dëgjuar. Në pyetjen e hapur që pason këtë deklaratë pozitive, për të ilustruar kontekstin e rastit ku dëshmohet dëgjimi i zërit të banorëve nga bashkia, banori është shprehur se zëri i tyre është dëgjuar një herë, konkretisht gjatë një takimi të organizuar për çështjen e pastrimit të lumit (Përroi i Manazderes). Përtej këtij rasti ilustrues, banorët e tjerë nuk kanë raportuar raste apo shembuj takimesh të tjera ku pjesëtarët e komunitetit të kenë pasur mundësi të shprehin mendimet apo shqetësimet e tyre.

Ndërkohë, pyetjes: “Ju personalisht, a keni marrë ndonjëherë pjesë në takime të organizuara nga bashkia?”, shumica dërrmuese e të intervistuarve i është përgjigjur me jo, duke deklaruar se nuk kanë marrë pjesë. Konkretisht, 96 banorë përbëjnë 57% të të anketuarve, të cilët kanë raportuar se nuk kanë marrë kurrë pjesë në takime të organizuara nga bashkia. Kjo përqindje tregon një pjesëmarrje të ulët të komunitetit në proceset vendimmarrëse lokale dhe një mungesë lidhjeje direkte me institucionet vendore.



Grafiku 8: Pjesëmarrja në takime të organizuara nga bashkia

Mungesa e deklaruar e kujtesës mbi pjesëmarrjen në takime të organizuara nga bashkia rezulton të jetë një gjetje e studimit me interes për t'u analizuar. Së pari, kjo deklaratë që lidhet me shkallën e ulët të pjesëmarrjes në proceset e vendimmarrjes lokale nga ana e banorëve, tregon mungesën e kujtesës mbi pjesëmarrjen, ku 62 banorë, ose 37% e të anketuarve shprehen se nuk e kujtojnë nëse kanë marrë pjesë në takime të organizuara nga bashkia. Njëkohësisht, ky fakt mund të interpretohet si tregues i pjesëmarrjes sporadike ose të paqëndrueshme të banorëve nëpër takime konsultuese ose vendimmarrëse. Pra, edhe kur takimet janë zhvilluar rregullisht, informacioni i përcjellë te banorët nuk ka qenë i rregullt, banorët nuk janë informuar mirë, ose takimet nuk janë perceptuar si të rëndësishme nga komuniteti. Në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, ky fakt reflekton mungesën e dialogut të vazhdueshëm dhe kanaleve efektive të komunikimit midis bashkisë dhe komunitetit.

Një tjetër gjetje e raportit studimor është se edhe në rastet e raportuara të pjesëmarrjes nga ana e banorëve, ajo rezulton minimale. Vetëm 9 persona, ose 5.4% të banorëve raportojnë se kanë marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes lokale. Kjo tregon se pothuajse i gjithë komuniteti nuk është përfshirë në mënyrë aktive dhe nuk ka pasur mundësi të ndikojë në vendimmarrjen lokale. Ky realitet i raportuar nga kjo pyetje e pyetësorit përputhet me perceptimin e mëparshëm ilustruar në Grafikon 7 se zëri i komunitetit nuk dëgjohet nga bashkia.

Këto të dhëna të drejtpërdrejta nga komuniteti, nënvizojnë nevojën për një sërë ndërhyrjesh. Së pari, ndërtimin e mekanizmave të përfshirjes së komunitetit, ku banorët të jenë të informuar dhe të ftuar të marrin pjesë rregullisht. Së dyti, planifikim të takimeve dhe konsultimeve të përshtatura me aftësitë, nevojat dhe oraret e komunitetit, duke përfshirë grupe të marginalizuara si të moshuarit, gratë dhe të rinjtë. Së treti, rritjen e besueshmërisë dhe transparencës përmes raportimeve të qarta mbi mënyrën se si mendimet e komunitetit përdoren në vendimmarrje.

Për të kuptuar më mirë shifrat e pjesëmarrjes, të anketuarve iu kërkua të specifikonin rrethanat konkrete që kanë motivuar përfshirjen e tyre ose arsyet që i kanë mbajtur larg takimeve të organizuara nga bashkia. Analiza cilësore e përgjigjeve të pyetjeve të hapura zbulon një panoramë komplekse, ku dominon ndjenja e përjashtimit për shkak të mungesës së informacionit

dhe skepticizmi mbi efektivitetin e këtyre dëgjësive. Një pjesë e konsiderueshme e banorëve që deklaruan mospjesëmarrje, e lidhin këtë drejtpërdrejt me mungesën e kanaleve të komunikimit institucional. Deklaratat e përsëritura si "s'na kanë njoftuar" apo "s'kanë marrë mundimin të njoftohet komuniteti", evidentojnë se bashkia nuk ka ndërmarrë një qasje proaktive për të siguruar që informacioni të mbërrijë te banorët e lagjes Rrapishtë, duke krijuar kështu një barrierë logjistike që në hapat e parë të procesit.

Shumica e të anketuarve raportojnë se kontakti i bashkisë me komunitetin është i kufizuar dhe sporadik, shpesh duke ndodhur vetëm gjatë periudhave të zgjedhjeve. Një pjesë e tyre theksojnë se bashkia "vjen vetëm atëherë kur janë zgjedhjet", duke pohuar se interesimi i autoriteteve vendore nuk është i vazhdueshëm dhe nuk synon adresimin real të nevojave të përditshme të komunitetit. Këto të dhëna në pyetësor tregojnë se banorët kanë një perceptim se mungon angazhimi i përhershëm dhe transparencë nga institucionet vendore. Nga ana tjetër, për ata qytetarë që kanë pasur kontakt me institucionin, pjesëmarrja shfaqet e motivuar kryesisht nga nevoja urgjente për ndërhyrje në infrastrukturë dhe mbijetesë ekonomike. Tematikat që kanë arritur të mobilizojnë banorët lidhen ngushtë me kërkesat për "asfaltimin e rrugëve", "ndriçimin" apo "investimin e lagjes".

Një gjetje me rëndësi kritike është mungesa e besimit të mekanizmat e konsultimit, veçanërisht brenda komunitetit Rom dhe Egjiptian. Disa të anketuar shprehen se kanë hequr dorë nga pjesëmarrja për shkak të mungesës së rezultateve konkrete në të shkuarën, duke theksuar se "bashkia bën takime, dëgjon problemet dhe në fund asgjë s'bën". Ky zhgënjim, i artikulluar përmes frazave si "nuk na japin zgjidhje", tregon se takimet perceptohen si formalitete burokratike pa fuqi reale ndryshimi. Rrjedhimisht, mospjesëmarrja në Rrapishtë nuk shfaqet si pasojë e apatisë qytetare, por si reagim ndaj një procesi që perceptohet si i largët ndaj nevojave specifike të komunitetit.

Megjithatë, disa përgjigje tregojnë përpjekjen e banorëve për të diskutuar shqetësimet konkrete, si për asfaltimin e rrugëve, ndriçimin dhe çështje social-ekonomike. Ky realitet tregon që komuniteti ka dëshirë për angazhim, por përballë barrierave të informimit dhe mungesës së përgjigjes konkrete, pjesëmarrja shpesh reduktohet ose bëhet simbolike. Në vija të përgjithshme, përgjigjet e banorëve tregojnë se pjesëmarrja e komunitetit në takimet konsultuese me bashkinë është sporadike, kryesisht për shkak të mungesës së njoftimit, përgjigjeve konkrete nga autoritetet dhe fokusit të bashkisë në periudha të caktuara të vitit. Kjo gjetje nënvizon nevojën për mekanizma të qëndrueshëm konsultimi, transparencë dhe angazhim të vazhdueshëm për të fuqizuar zërin e komunitetit në vendimmarrjen lokale.

3.2 Përfshirja konkrete

Për të zbërthyer shkaqet e mospjesëmarrjes qytetare, të anketuarve iu kërkua të identifikonin faktorët specifikë që i pengojnë të marrin pjesë në takimet e bashkisë. Të dhënat e mbledhura nga 167 të anketuar nxjerrin në pah mungesë besimi nga ana e banorëve, ku pengesa kryesore e raportuar prej tyre nuk është logjistike, por institucionale. Fakti që 44.3% e të anketuarve (74 persona) identifikojnë "Mosbesimin tek institucionet" si pengesë kryesore, është treguesi më shqetësues i këtij raporti.


Njëkohësisht, raporti evidenton pengesa në komunikim midis bashkisë dhe komunitetit. Konkretisht, 37.1% e qytetarëve raportojnë mungesë të përgjithshme informacioni, 32.9% mosnjohim në kohë, dhe 29.9% deklarojnë se nuk marrin asnjë lloj njoftimi. Kjo tregon se kanalet tradicionale të komunikimit që përdor bashkia, qofshin ato online apo përmes afishimeve në qendër të qytetit, nuk arrijnë të depërtojnë brenda lagjes, duke përjashtuar një pjesë të madhe të banorëve.

Një faktor tjetër që del nga të dhënat lidhet me përjashtimin social dhe barrierat kulturore. Si fillim, 37.1% e të anketuarve citojnë "Barrierat gjuhësore dhe arsimore" si pengesë, duke lënë të kuptohet se formati i takimeve mund të jetë tepër teknik ose burokratik për nivelin e tyre të kuptuarit. Më tej, 26.9% e pjesëmarrësve raportojnë "Diskriminimin" si pengese apo arsye për mospjesëmarrje, çka nënkupton se dëgjuesat nuk perceptohen si hapësirë e sigurt dhe gjithëpërfshirëse, por si një terren ku ata mund ndihen të paragjykuar ose të pabarabartë.

Në fund, një rezultat interesant i kësaj pyetjeje është se vetëm një përqindje e papërfillshme prej 6.6% u shprehën se "nuk duan të përfshihen" dhe vetëm 4.2% përmendën "mungesën e kohës" si pengesë. Këto shifra tregojnë se banorët e Rrapishtës e kanë edhe kohën, edhe vullnetin për të qenë pjesë e vendimmarrjes. Ajo që i mban larg nuk është indiferenca e tyre, por kombinimi i mosbesimit ndaj institucionit, mungesës së informacionit dhe ndjenjës ose perceptimit i të qenit të papërshtatshëm apo të diskriminuar në sytë e administratës.

11. Çfarë të pengon të shkosh në takimet e bashkisë? (mund të zgjidhni më shumë se një)

167 responses



Grafiku 9: Pengesat për të marrë pjesë në takimet e organizuara nga bashkia


Këto gjetje nënvizojnë faktin se mungesa e informacionit dhe e komunikimit efektiv kontribuon direkt në ndjesinë e marginalizimit. Kur takimet nuk njoftohen në kohë ose kur barrierat gjuhësore dhe arsimore pengojnë pjesëmarrjen, banorët nuk kanë mundësi të artikulojnë shqetësimet e tyre dhe ndihen të injoruar. Ndërkohë, perceptimet e diskriminimit dhe mosbesimit

tek institucionet, edhe pse në përqindje më të vogla, përforcojnë ndjenjën se mekanizmat ekzistues të përfshirjes nuk janë funksionalë për komunitetin Rom dhe Egjiptian.

Si rrjedhojë, të dhënat tregojnë një lidhje të drejtpërdrejtë mes barrierave praktike/strukture për pjesëmarrje dhe ndjesisë së mungesës së dëgjimit të zërit. Kjo gjë nënvizon nevojën për njoftime të rregullta, komunikim të qartë dhe mekanizma gjithëpërfshirës që adresojnë barrierat arsimore, gjuhësore dhe perceptivë, për të fuqizuar zërin dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit Rom dhe Egjiptian në vendimmarrje.

3.2.1 A mendoni se bashkia bashkëpunon me shoqatat për të ndihmuar komunitetin?

Të dhënat e pyetësorëve tregojnë se shumica dërrmuese e komunitetit (87%) beson se bashkia bashkëpunon me Organizatat Jofitimprurëse (OJF) për të ndihmuar komunitetin. Kjo tregon një perceptim pozitiv mbi përpjekjet e bashkisë për të krijuar ura bashkëpunimi me organizatat komunitare dhe anasjelltas, që mund të përdoren si kanal për mbështetje, informim dhe përfshirje në vendimmarrje.



Grafiku 10: Bashkëpunimi mes bashkisë dhe OJF-ve


Megjithatë, rreth 11% e të anketuarve janë shprehur se nuk e dinë nëse bashkia bashkëpunon me shoqatat, duke reflektuar mungesë informacioni ose transparence në lidhje me aktivitetet dhe projektet e përbashkëta. Një grup i vogël të intervistuarish, vetëm 2%, mendon se nuk ka bashkëpunim, çka mund të lidhet me mosndërgjegjësim për aktivitetet e zhvilluara ose perceptim negativ bazuar në përvojat e tyre direkte.

Të dhënat tregojnë se të anketuarit kanë një perceptim relativisht të mirë për bashkëpunimin me shoqatat, por kanë nevojë për komunikim më të qartë dhe informim të vazhdueshëm, në mënyrë që i gjithë komuniteti të jetë i vetëdijshëm për mundësitë dhe përfitimet që vijnë nga ky bashkëpunim.

3.2.2 A ke dëgjuar ti të ketë ardhur stafi i bashkisë në lagjen tuaj për të folur mbi buxhetin?

Të dhënat e raportuara tregojnë mungesë të përfaqësuesve të bashkisë në lagje për të diskutuar mbi buxhetin. Vetëm një person raporton se ka marrë informacion ose është përfshirë në një takim të tillë, ndërsa pothuajse i gjithë komuniteti raporton se nuk ka marrë pjesë.

Ky rezultat nënvizon një mungesë të komunikimit dhe transparencës nga bashkia, sidomos për çështje kritike si buxheti lokal, i cili është një instrument vendimtar për vendimmarrje dhe investime në komunitet. Kjo mungesë kontribuon drejtpërdrejt në ndjesinë e izolimit dhe mosdëgjimit të zërit të komunitetit, duke reduktuar mundësinë që banorët të ndikojnë në prioritetet që i prekin drejtpërdrejt ata.




Grafiku 11: A ke dëgjuar ti të ketë ardhur stafi i bashkisë në lagjen tuaj për të folur mbi buxhetin?

Pra, të dhënat tregojnë se diskutimet mbi buxhetin lokal nuk po arrijnë tek komuniteti, dhe kjo gjë nënvizon nevojën për kanale efektive komunikimi dhe përfshirje të drejtpërdrejtë që fuqizojnë pjesëmarrjen dhe transparencën e vendimmarrjes vendore.

3.2.3 Me sa di ti, a ka ardhur stafi i bashkisë të japë llogari për buxhetin?

Asnjë nga të anketuarit nuk ka raportuar se përfaqësues të bashkisë kanë ardhur në lagjen e tyre të bisedojnë, informojnë apo të zhvillojnë takime të llogaridhënies mbi buxhetin për komunitetin në lagjen Rrapishtë. Ky perceptim nga ana e komunitetit pasqyron një mungesë transparence dhe dialogu institucional mbi çështjet financiare që ndikojnë drejtpërdrejt tek komuniteti.



Grafiku 12: Me sa di ti, a ka ardhur stafi i bashkisë të japë llogari për buxhetin?

Këto përgjigje përcjellin ndjesinë që zëri i komunitetit nuk dëgjohej dhe se banorët nuk kanë mundësi të kontrollojnë ose të ndikojnë në përdorimin e burimeve publike. Mungesa e llogaridhënies financiare mund të shkaktojë mosbesim ndaj institucioneve vendore dhe të pengojë pjesëmarrjen aktive në proceset vendimmarrëse.

Pra, këto të dhëna nënvizojnë nevojën për mekanizma efektivë llogaridhënieje dhe transparence, përfshirë takime të rregullta, raporte të qarta dhe të kuptueshme mbi buxhetin dhe informim të drejtpërdrejtë të komunitetit, çka do të rriste pjesëmarrjen dhe besimin në institucionet vendore.

3.3 Nevojat e banorëve përballë bashkisë

3.3.1 Cilat shërbime publike nga ana e bashkisë mendoni se funksionojnë më mirë në lagjen tuaj?

Nga një total prej 167 përgjigjesh ndaj kësaj pyetjeje të hapur, rezulton se pastrimi i lumit/përroit përbën shërbimin publik më të dukshëm dhe të perceptuar si më funksional nga banorët e lagjes Rrapishtë. Për shumicën dërrmuese të të anketuarve ky shërbim është thelbësor për menaxhimin e mjedisit dhe për higjienën publike. Përgjigjet e shpeshta të banorëve për pastrimin e lumit tregojnë angazhimin e ndërhyrjes së bashkisë në një dimension të dukshëm të jetës së komunitetit, i cili vlerësohet nga banorët. Megjithatë, komentet e banorëve tregojnë se realizimi i kësaj ndërhyrjeje ka qenë jo i vazhdueshëm dhe shpeshherë jo në mënyrën e pritshme nga ata, duke ngritur pyetje rreth planifikimit, kohës së implementimit dhe qëndrueshmërisë së shërbimit.

Një grup më i vogël banorësh kanë përmendur rregullimin e shtëpive si një shërbim publik që ka ndodhur “herë pas here”. Siç raportohet nga të intervistuarit, këto ndërhyrje janë të karakterit sporadik dhe të paqarta për komunitetin, duke mos krijuar një ndjenjë të qartë të qëndrueshmërisë së veprimeve. Disa persona përmendën gjithashtu shërbime të tjera që kanë ndodhur rrallë, të tilla si pastrimi i rrugëve, ndriçimi, përmirësimi i infrastrukturës në shkollën “Hamit Mullisi” dhe largimi i mbeturinave. Shembujt e përmendur ilustrojnë një perceptim të

gjerë se bashkia i mundëson disa shërbime, por ato janë të pakta, dhe të shpërndara në mënyrë jo të qëndrueshme.

Një grup më i madh banorësh shprehin mendimin se asgjë konkrete nuk është ndërmarrë në mënyrë sistematike për të adresuar nevojat kyçe. Një pjesë e konsiderueshme, duke përfshirë ata që u shprehën me përgjigje si “*Asgjë*”, “*Nuk kam parë*” ose “*Pak*”, shpreh një ndjenjë të qartë të mungesës së shërbimeve të ofruara, çka nënkupton një nivel të ulët besimi në institucionet vendore për të ofruar zgjidhje.

Ky perceptim thekson nevojën e jashtëzakonshme për një qasje më të koordinuar dhe të vazhdueshme nga ana e bashkisë, e cila pritet të identifikojë, planifikojë dhe të zbatojë një sërë shërbimesh bazë në mënyrë të rregullt. Rasti i lagjes Rrapishtë kërkon një proces të qartë të renditjes së prioriteteve, zhvillimin e mekanizmave të komunikimit me banorët, dhe një angazhim në zhvillimin e projekteve infrastrukturore. Gjithashtu, ndërtimi i besimit të komunitetit tek institucionet dhe kontributi institucional në përmirësimin e cilësisë së jetesës kërkon një plan ndërhyrjesh me faza të qarta implementimi, i cili mund të krijojë një mjedis në përgjigje të nevojave të të gjithë banorëve.

3.3.2. Sipas mendimit tuaj, cilat janë 3 problemet kryesore që ka komuniteti Rom dhe Egjiptian në lagjen Rrapishtë?

Për të identifikuar nevojat reale dhe më urgjente të lagjes Rrapishtë, të anketuarve iu kërkua të listonin tri problemet kryesore me të cilat përballet komuniteti Rom dhe Egjiptian në përditshmërinë e tij. Analiza e fjalëve kyçe nga 167 përgjigje zbulon një konsensus pothuajse absolut: kërkesat e banorëve nuk lidhen me luks apo shërbime dytësore, por me investime bazike infrastrukturore që prekin drejtpërdrejt dinjitetin njerëzor dhe standardet minimale të jetesës. Në krye të listës së prioriteteve qëndron një trekëndësh i pandashëm problemesh: asfaltimi, ndriçimi dhe kanalizime/furnizimi me ujë.

Asfaltimi i rrugëve shfaqet si kërkesa dominuese, e përmendur pothuajse në çdo përgjigje të të anketuarve. Përdorimi masiv i këtij termi tregon se gjendja fizike e rrugëve në lagje është tejet e degraduar, duke vështirësuar lëvizjen e përditshme, duke izoluar zonën dhe duke e lënë atë "në baltë". Paralelisht me infrastrukturën rrugore, ndriçimi publik renditet si një emergjencë e dytë madhore. Mungesa e tij lidhet ngushtë me ndjenjën e pasigurisë gjatë natës, një element kritik për banorët e një zone periferike. Gjithashtu, kërkesat për ujë të pijshëm (shpesh të specifikuar si "*ujë 24 orë*") dhe kanalizime dëshmojnë se Rrapishta ende vuan nga mungesa e shërbimeve më elementare, çka përbën një rrezik të vazhdueshëm higjieno-sanitar.


Krahas infrastrukturës, një vëmendje e veçantë i kushtohet higjienës publike dhe menaxhimit të mbetjeve urbane. Një numër i konsiderueshëm banorësh identifikojnë "*pastrimin*" dhe mungesën e "*koshave të mbeturinave*" si probleme kritike. Referencat specifike, si nevoja për pastrimin e zonës së Namazderës, tregojnë se shërbimi aktual i pastrimit nga bashkia perceptohet si i pamjaftueshëm, duke e kthyer lagjen në një vatër mbetjesh që rëndon më tej cilësinë e jetës.

Ndërkohë, ndonëse infrastruktura fizike dominon problemet kryesore të raportuara nga banorët, nuk mungojnë as kërkesat për ndërhyrje socio-ekonomike. Një numër i rëndësishëm përgjigjesh nga ana e komunitetit ngrenë çështjet e arsimit, punësimit dhe strehimit. Përmendja e shpeshtë e

"arsimit" tregon një ndërgjegjësim në rritje për rëndësinë e shkollimit në komunitet, ndërsa kërkesat për "tapi" (legalizim) dhe zgjidhjen e "skamjes" evidentojnë pasigurinë e thellë ekonomike dhe ligjore me të cilën përballen familjet. Megjithatë, mesazhi kryesor që buron nga këto të dhëna është i qartë: para çdo ndërhyrjeje tjetër, banorët e Rrapishtës kërkojnë urbanizimin bazik të lagjes së tyre.

3.3.3. Cili është shërbimi publik më urgjent që duhet përmirësuar nga bashkia?

Të dhënat nga pyetja mbi shërbimin publik të perceptuar si më urgjentin për banorët, tregojnë qartësisht se asfaltimi i rrugëve është shërbimi publik më urgjent për komunitetin Rom dhe Egjiptian në lagjen Rrapishtë. Shumica dominuese e të anketuarve, 141 nga 167 (afërsisht 84,4%), e identifikojnë asfaltimin si prioritetin kryesor. Ky konsensus tregon një perceptim të besueshëm të nevojës për përmirësim të infrastrukturës së rrugëve.



Grafiku 13. Sipas mendimit tuaj, cili është shërbimi publik më urgjent që duhet përmirësuar nga bashkia?

Kur të anketuarve iu kërkua të veçonin vetëm një shërbim publik si më urgjentin për t'u përmirësuar nga bashkia, rezultatet e përfuara nga grafiku paraqesin një qëndrim të qartë. Ndryshe nga pyetjet e tjera ku opinionet e të anketuarve mund të jenë të shpërndara, këtu vërehet një kërkesë e qartë qytetare drejt infrastrukturës rrugore. Kolona e "Asfaltimit të rrugëve" dominon në mënyrë dërrmuese mbi çdo kategori tjetër, duke mbledhur rreth 85% të të gjitha përgjigjeve, me 141 përgjigje nga 167 të anketuar.


Ky rezultat tregon se për banorët e lagjes Rrapishtë, mungesa e rrugëve të asfaltuara nuk është thjesht një shqetësim mes shumë të tjerëve, por çështja kryesore e cilësisë së jetesës së tyre. Kjo nuk do të thotë se banorët nuk kanë nevojë për arsim apo ujë (siç u pa në analizën e pyetjeve të hapura), por kur detyrohen të zgjedhin shërbimin publik më urgjent, balta dhe rrugët e pakalueshme janë problemi që i shqetëson më së shumti në përditshmërinë e tyre.

Fakti që kategori si *"Hapësirat e gjelbërta"*, *"Hapësirat rekreative"* apo *"Shërbimi i pastrimit"* kanë marrë vlera minimale, përforcon argumentin se komuniteti ndodhet ende në fazën e nevojës për infrastrukturën bazike të mbijetesës urbane. Në hierarkinë e nevojave të Rrapishtës, luksi i parqeve apo këndeve të lojërave është i paimagjinueshëm për sa kohë që mungon aksesit fizik normal në banesa. Ky grafik i jep një mesazh të qartë bashkisë: çdo plan investimi për këtë zonë duhet të fillojë, pa asnjë mëdyshje, me shtrimin e rrugëve.

3.3.4 Sa të kënaqur jeni me shërbimet aktuale të bashkisë në lagjen tuaj?

Për të matur perceptimin e përgjithshëm të komunitetit mbi performancën e administratës vendore, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin nivelin e tyre të kënaqësisë mbi shërbimet aktuale në lagjen Rrapishtë. Rezultatet e grafikut ofrojnë një pasqyrë ku pakënaqësia nuk është thjesht dominuese, por pothuajse unanime. Kolonat që përfaqësojnë vlerësimet pozitive *"Shumë të kënaqur"* dhe *"Të kënaqur"* janë bosh, duke treguar se asnjë nga 167 të anketuarit nuk e konsideron situatën aktuale si të pranueshme apo të mirë.

Alternativa *"Aspak të kënaqur"* dominon masivisht shpërndarjen e përgjigjeve, duke përfshirë rreth 80% të kampionit (135 persona). Niveli i ulët i kënaqësisë shfaqet si gjetje kryesore, çka tregon se shumica dërrmuese e banorëve ndiejnë zhgënjim ndaj mënyrës se si bashkia po menaxhon lagjen e tyre. Kjo përqindje e lartë lë të kuptohet se besimi i të intervistuarve në institucionet lokale është i ulët. Gjithashtu vërehet edhe një perceptim i lartë pakënaqësie ndaj performancës së bashkisë në ofrimin e shërbimeve të nevojshme për komunitetin. Ndonëse mund të ketë pasur përpjekje për përmirësime të kufizuara në dimensione të caktuara, ato nuk kanë qenë të mjaftueshme për të ndryshuar perceptimin e përgjithshëm të një komuniteti që ndihet i lënë pas dore.



Grafiku 14: Sa të kënaqur jeni me shërbimet aktuale të bashkisë në lagjen tuaj?

Pjesa e mbetur e të anketuarve, rreth 20% (32 persona), pozicionohen në kategorinë *"Pak të kënaqur"*. Ndonëse ky grupim nuk shpreh entuziazëm të plotë, prania e këtij segmenti tregon se brenda komunitetit ekziston ende një bërthamë qytetarësh që njohin disa përpjekje minimale ose që ruajnë një fije shprese te institucioni. Ky grupim përfaqëson një potencial strategjik për

bashkinë, pasi ata janë qytetarë që nuk e kanë refuzuar plotësisht dialogun dhe që, me ndërhyrje të përqendruara, mund të shndërrohen lehtësisht në mbështetës të ndryshimit dhe në partnerë aktivë për zhvillimin e lagjes. Kjo tregon se besimi nuk është shkatërruar plotësisht dhe se ka ende hapësirë për të rindërtuar urat e bashkëpunimit përmes investimeve konkrete.

Në thelb, mesazhi që buron nga këto të dhëna evidenton një distancë midis nevojave urgjente të lagjes dhe reagimit të bashkisë. Kjo pakënaqësi ushqehet edhe nga mungesa e komunikimit të hapur, e cila perceptohet si mungesë transparence dhe përfshirjeje në vendimmarrje. Për rrjedhojë, sfida nuk kufizohet vetëm te ofrimi i shërbimeve fizike, por prek drejtpërdrejt besueshmërinë e qeverisjes vendore. Për të adresuar këtë situatë, nuk mjaftojnë zgjidhjet e shpejta dhe afatshkurtra. Përkundrazi, nevojitet një plan i ri komunikimi dhe një mekanizëm i fortë llogaridhënieje, i cili të integrojë qytetarët në monitorimin e shërbimeve dhe të rikthejë besimin përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse.

3.3.5 “Po sikur të takoje kryetarin e bashkisë, çfarë do t’i thojë?”

Në pyetjen e parafundit të studimit, ku qytetarëve iu dha mundësia hipotetike për t’i drejtuar një mesazh të drejtpërdrejtë Kryetarit të Bashkisë, kryefjala absolute mbetet emergjenca infrastrukturore. Analiza e qindra përgjigjeve tregon se për banorët e Rrapishtës, komunikimi me kreun e pushtetit vendor nuk është moment për retorikë, por një thirrje e dëshpëruar për të ndërhyrë në gjendjen fizike të lagjes. Fjala “*asfaltim*” theksohet në mënyrë të përsëritur në shumicën dërrmuese të mesazheve, e shoqëruar shpesh me kërkesa për “*ndriçim*” dhe “*ujë*”, duke konfirmuar se përpara çdo kërkesë tjetër, banorët kërkojnë zgjidhjen e problemit që u vështirëson jetën sapo dalin nga shtëpia.

Përtej kërkesave teknike, ligjërimi i të anketuarve zbulon një kërkesë të thellë për barazi qytetare dhe dinjitet social. Një linjë e përbashkët që përshkon shumë nga mesazhet është insistimi se komuniteti Rom dhe Egjiptian nuk kërkon trajtim preferencial, por të drejtën legjitime për t’u trajtuar njëllëj si pjesa tjetër e qytetit. Fraza prekëse si “*të ofrojë shërbime më të mira sepse dhe ne jemi qytetarë të Elbasanit si gjithë të tjerët*” apo “*asfalto Rrapishtën si gjithë lagjet e tjera*”, dëshmojnë për një pjekuri qytetare që refuzon statusin e qytetarit të dorës së dytë dhe i kujton Kryetarit detyrimin e tij për të qenë përfaqësues i të gjithëve, pa dallim zone apo etnie.

Një dimension tjetër interesant është ftesa e hapur për prani fizike të autoriteteve në terren, si mjet për të thyer neglizhencën institucionale. Shumë banorë besojnë se distanca e administratës është shkaku kryesor i harresës, ndaj i drejtohen Kryetarit me thirrje të tipit “*të vijë të bëjë takime me komunitetin*”, “*të shikojë lagjen nga afër, sidomos kur bie shi*” apo “*të dëgjojë me vëmendje*”. Këto ftesa sugjerojnë se komuniteti është i bindur që, nëse vendimmarrësit do të përballeshin drejtpërdrejt me realitetin e vështirë, jashtë fushatave elektorale, ata do të ishin të detyruar moralisht të reagonin. Kjo reflekton një nevojë të madhe për vëmendje personale dhe për një dialog të drejtpërdrejtë, ku zëri i qytetarit të dëgjohet pa filtra burokratikë.

Pavarësisht thirrjeve për ndërhyrje, nuk mungojnë zërat që shprehin dorëzim dhe mosbesim total ndaj efektivitetit të këtij dialogu. Një pjesë e të anketuarve zgjedh të përgjigjet me fraza si “*asgjë, sepse nuk na marrin parasysh fjalët*” apo “*fjalët bien në vesh të shurdhër*”, duke dëshmuar se për ta, premtimet e thyera në të shkuarën kanë dëmtuar çdo pritshmëri. Kjo ndjenjë izolimi përforcon

mesazhin se sfida e bashkisë nuk është vetëm shtrimi i rrugëve, por edhe rikthimi i besimit të humbur. Për ta adresuar këtë, komunikimi dhe llogaridhënia duhet të përmirësohen ndjeshëm, duke mundësuar një raport të vërtetë dhe jo thjesht formal me institucionet.

3.3.6 Si mendoni, çfarë duhet të bëjë bashkia që t'i dëgjohet zëri komunitetit Rom dhe Egjiptian?

Në pyetjen e fundit mbi mekanizmat që bashkia duhet të përdorë për të dëgjuar zërin e komunitetit Rom dhe Egjiptian, përgjigjet e qytetarëve të anketuar orientohen drejt një zgjidhjeje të vetme dhe të qartë: kontakti i drejtpërdrejtë njerëzor në terren. Fjalët kyçe "*takim me komunitetin*", "*të vijë në lagje*" dhe "*të jetë më pranë*" përsëriten në pothuajse çdo përgjigje, duke sinjalizuar se banorët e shohin praninë fizike të zyrtarëve jo thjesht si një akt administrativ, por si parakushtin themelor për ndërtimin e besimit. Shumica dërmuese e të anketuarve theksojnë nevojën për takime të shpeshta, të vërteta dhe jo thjesht simbolike, ku anëtarët e komunitetit të kenë mundësinë të shprehin problemet në hapësirat e tyre të përditshme.

Përtej formatit fizik të takimeve, analiza e ligjërimit zbulon një dëshirë të theksuar për një qasje më humane, empatike dhe me respekt reciprok. Fraza si "*të bëhen me zemër të gjerë*", "*të vërë dorën në zemër për Rrapishtën*" apo "*të sillet mirë me komunitetin*", tregojnë se banorët kërkojnë më shumë sesa thjesht zgjidhje teknike; ata kërkojnë dinjitet dhe dëgjim aktiv. Ata duan të ndihen si pjesë integrale e procesit vendimmarrës dhe të shohin se shqetësimet e tyre merren parasysh seriozisht.

Së fundmi, mesazhi i komunitetit është i qartë: koha e premtimeve ka mbaruar, tani nevojiten veprime konkrete dhe konsistencë. Banorët theksojnë me forcë se bashkia nuk duhet të jetë e pranishme vetëm në periudha zgjedhore, por të ketë një angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin e kushteve të jetesës, si infrastruktura dhe shërbimet bazë. Megjithatë, brenda kësaj kërkese rigoroze, ekziston një fije e fortë shprese. Fakti që shumica kërkojnë "*takime të shpeshta*" dhe "*të punojë me komunitetin*", tregon se ata nuk e kanë refuzuar institucionin, por po e ftojnë atë në partneritet. Kjo gatishmëri për të folur dhe për të bashkëpunuar është një aset i vyer për bashkinë, një derë e hapur që pret vetëm vullnetin politik dhe mekanizmat e duhur për t'u kapërcyer.

4. Diskutim dhe analizë e rezultateve

4.1 Diskutim: Besimi përtej mungesës së investimeve

Gjetjet e këtij raporti studimor vendosin në qendër të diskutimit një problematikë që shkon përtej ankesave materiale për mungesën e investimeve, duke dëshmuar për një hendek në marrëdhënien midis komunitetit Rom dhe Egjiptian në Rrapishtë dhe institucionit që duhet t'i përfaqësojë, Bashkisë së Elbasanit. Kur rreth 70% e të anketuarve deklarojnë se bashkia nuk ka investuar fare dhe kur 135 nga 167 banorë besojnë se zëri i tyre nuk dëgjohet tek vendimmarrësit, ne nuk kemi të bëjmë thjesht me një perceptim negativ të momentit, por me një përvojë të përsëritur mos-përfshirjeje. Në termat e qeverisjes vendore, kjo situatë sinjalizon një dobësim kritik të dy shtyllave bazë: legjitimitetit (besimi se bashkia vepron në interes të komunitetit) dhe përgjegjshmërisë (bindja se kërkesat e qytetarëve prodhojnë reagim institucional).

Një dimension kritik i këtyre dinamikave është pozicionimi i komunitetit jo si "partner" në zhvillimin lokal, por si "objekt" pasiv i vendimeve të marra diku tjetër. Kjo asimetri pushteti krijon një cikël negativ që përforcohet: sa më pak komunikim dhe transparencë të ketë, aq më pak besim krijohet; sa më pak besim, aq më pak pjesëmarrje; dhe sa më pak pjesëmarrje, aq më pak presion institucional për llogaridhënie. Në këtë kuptim, hendeku midis Rrapishtës dhe Bashkisë nuk është vetëm administrativ; ai është thellësisht social dhe politik, duke krijuar një ndjesi të fortë mos-përfshirjeje të banorët.

Niveli minimal i pjesëmarrjes në takimet e bashkisë (5.4%, shiko grafikun 8) duhet lexuar si tregues. Së pari, ai reflekton mungesën reale të aksesit për shkak të njoftimeve jofunksionale, orareve që përplasen me punën informale, apo formateve "zyrtare" që dekurajojnë banorët me arsimim të ulët. Së dyti, ai tregon mungesën e besimit se këto takime prodhojnë rezultat. Fakti që një pjesë e konsiderueshme "*nuk e mban mend*" nëse ka marrë pjesë, sugjeron se konsultimet, edhe kur ndodhin, nuk janë të strukturuar si procese me rëndësi dhe vazhdimësi për banorët. Kjo e bën pjesëmarrjen të duket e parëndësishme dhe jo si një ngjarje reale komunitare.

Pengesat e raportuara, si mungesa e informacionit, barrierat gjuhësore dhe ndjenja e diskriminimit, duhet të kuptohen si pengesa të ndërthurura dhe jo si faktorë të izoluar. Për shembull, niveli i ulët arsimor e bën më të vështirë të kuptuarit e procesit të buxhetimit. Kjo rrit ndjenjën e përjashtimit e cila mund të lexohet si diskriminim, sidomos kur përvojat e mëparshme kanë pasur elemente stigmatizimi. Kështu, pengesat që mund të duken "teknike" (komunikim, njoftim), kthehen në përjetim social negativ ("*nuk na duan*", "*nuk na konsiderojnë*"), duke rritur distancën me institucionin.

Është thelbësore të kuptohet se "mungesa e investimeve" është sa problem real, aq edhe problem perceptimi dhe komunikimi. Edhe në rastet kur mund të ketë pasur ndërhyrje të pjesshme, nëse ato nuk shoqërohen me komunikim publik, shpjegim prioritetesh dhe raportim rezultatesh, ato nuk arrijnë të ndërtojnë besim. Për komunitetet e marginalizuara, investimi nuk matet vetëm me punime fizike, por me ndjesinë e barazisë së trajtimit: "*A u pyetëm*"? "*A u mor parasysh nevoja jonë*"? "*A u respektua dinjiteti ynë*"? Kur këto pyetje mbeten pa përgjigje, marrëdhënia bashki-komunitet ngurtësohet në një raport distancë-mosbesim.

4.2 Analizë e rezultateve: Pjesëmarrja përtej shkaqeve të përjashtimit

Rezultatet e këtij raporti studimor tregojnë se ekziston një lidhje e fortë midis kushteve të vështira socio-ekonomike dhe aftësisë për pjesëmarrje efektive në vendimmarrjen vendore. Kur një komunitet karakterizohet nga papunësia, puna informale dhe lufta për mbijetesë, pjesëmarrja qytetare bëhet "kosto" për ta (humbje kohe, shpenzime transporti, humbje e ditës së punës) dhe jo "investim" me përfitim të dukshëm. Kjo gjë ndikon në zgjedhjen e qytetarëve për të mos shpenzuar energji në procese ku nuk shohin rezultat. Pra, pjesëmarrja e ulët nuk është tregues apatie; shpesh është strategji mbijetese në një kontekst ku përfitimi i angazhimit perceptohet si minimal.

Barrierat gjuhësore dhe arsimore dalin si faktorë të rëndësishëm sepse mekanizmat e bashkisë mbi informimin në kuadër të procesit të buxhetimit ndjekin një standard uniform për të gjithë qytetarët. Njoftimet e shkruara me gjuhë zyrtare, dokumentet e gjata dhe terminologjia teknike

krijojnë një mjedis përjashtues për banorët e Rrapishtës. Ky realitet mund të përbëjë "*përjashtim procedural*": rregullat dhe formatet janë formalisht të njëjta për të gjithë, por në praktikë ato përjashtojnë ata që nuk kanë mjetet për t'i kuptuar dhe përdorur, duke krijuar pabarazi de facto.

Mungesa e theksuar e informimit mbi buxhetin lokal tregon se transparenca "në letër" (publikimi online) nuk barazohet me transparencë "në praktikë". Për komunitete të marginalizuara, transparenca duhet të jetë e përkthyer (në gjuhë të thjeshtë), e afërt (takime fizike në lagje), dhe e verifikueshme (raportim i qartë se çfarë u bë me premtimet). Kur kjo mungon, buxheti perceptohet si instrument i mbyllur dhe bashkia si institucion i largët, gjë që ushqen bindjen se vendimmarrja është e orientuar vetëm në drejtim të disa lagjeve, jo për të gjitha.

Një interpretim i rëndësishëm i rezultateve është roli i diskriminimit të perceptuar. Edhe nëse nuk provohet drejtpërdrejt diskriminim ligjor, vetë perceptimi i tij është tregues: ai sinjalizon se qytetarët e përjetojnë marrëdhënien me institucionin si të pabarabartë. Në këtë kontekst, çdo vonesë burokratike, çdo mungesë përgjigjeje apo çdo konsultim formal pa rezultat, lexohet automatikisht si konfirmim i paragjyqimit. Kjo rrit rezistencën ndaj angazhimit dhe e vështirëson punën e bashkisë, pasi asaj i duhet të rikthejë besimin moral para se të zbatojë projekte teknike.

Nga ana tjetër, besimi më i lartë te OJF-të sugjeron se ekzistojnë "aktorë besimi" që komuniteti i pranon më lehtë. Kjo hapësirë tregon se zgjidhja qëndron te ndërtimi i mekanizmave të përbashkët bashki-komunitet, ku OJF-të nuk zëvendësojnë bashkinë, por ndihmojnë në krijimin e strukturave të qëndrueshme. Ndërlidhësit komunitarë, strukturat komunitare dhe konsultimet e rregullta me rikthim përgjigjesh mund të shërbejnë si ura për të kaluar nga gjendja aktuale drejt një partneriteti funksional.

5. Rekomandime

Gjetjet e këtij raporti studimor tregojnë se sfida kryesore në lagjen Rrapishtë nuk është vetëm mungesa e financimeve, por mungesa e mekanizmave efektivë që lidhin qytetarin me vendimmarrjen. Për të rikthyer besimin në qeverisjen vendore, rekomandohet zbatimi i një qasjeje të integruar që ndërhyjnë në gjashtë shtylla kryesore:

1. Institucionalizimi i mekanizmave të rregullt të konsultimit

Për të rrëzuar perceptimin se bashkia "vjen vetëm për zgjedhje", është e rëndësishme që dialogu të kthehet në rutinë institucionale dhe jo në ngjarje sporadike. Kjo gjë mund të arrihet përmes disa hapave, si më poshtë:

- 1. Kalendari i rregullt:** Hartimi dhe shpallja e një kalendari vjetor konsultimesh publike në Rrapishtë. Kjo krijon siguri te banorët se zëri i tyre ka një hapësirë të garantuar.
- 2. Takimet fizike:** Takimet duhet të zhvillohen brenda territorit të lagjes, në hapësira të njohura dhe të sigurta për komunitetin (si shkolla apo qendra komunitare), dhe në orare të përshtatshme për banorët.

2. Thyerja e barrierave të komunikimit

Meqenëse "mungesa e informacionit" dhe "barrierat arsimore" u identifikuan si pengesa madhore, komunikimi duhet të përshtatet me profilin e komunitetit, çka mund të arrihet si më poshtë:

- 1.Gjuhë e thjeshtëzuar dhe kanale alternative:** Zëvendësimi i gjuhës tepër zyrtare me njoftime të thjeshta, të cilat duhet të shpërndahen aty ku është komuniteti: përmes afishimeve në terren, pikave të informimit, rrjeteve sociale lokale dhe gojarisht përmes ndërlidhësve komunitarë.
- 2.Komunikimi vizual:** Përdorimi i posterave me ikona dhe materialeve vizuale për të shpjeguar investimet apo buxhetin, duke ulur barrierat për banorët me nivel më të ulët arsimor.
- 3.Asistencë e dedikuar:** Sigurimi i ndihmës gjuhësore ose ndërmjetësimi gjatë takimeve për të garantuar që askush të mos ndihet i përjashtuar për shkak të pamundësisë për të artikuluar kërkesën "zyrtarisht".

3. Raportimi dhe monitorimi i buxhetit

Për të adresuar mungesën e transparencës funksionale, buxheti duhet të "zbresë" në nivel lagjeje.

- 1.Raportim i thjeshtuar:** Publikimi periodik i raporteve vizuale që tregojnë qartë: çfarë u premtua, çfarë u realizua dhe çfarë mbeti pezull.
- 2.Monitorimi komunitar:** Krijimi i një grupi vullnetar monitorimi nga lagjia (me përfaqësim të grave dhe të rinjve Rom/Egjiptian), i cili ndjek ecurinë e punimeve në terren dhe raporton te bashkëqytetarët, duke rritur transparencën dhe presionin pozitiv për cilësi.

4. Fuqizimi i kapaciteteve për vetë-përfaqësim

Që pjesëmarrja të jetë efektive dhe jo formale, komuniteti duhet të pajiset me mjetet e duhura. Ky fuqizim mund të arrihet edhe falë bashkëpunimit me OJF-të lokale.

- 1.Trajnime praktike:** Ofrimi i trajnimeve konkrete (jo vetëm teorike) mbi të drejtat qytetare, funksionimin e bashkisë dhe procedurat praktike: "*Si shkruhet një ankesë?*", "*Ku dorëzohet?*", "*Si ndiqet statusi i saj?*".
- 2.Mbështetja e liderëve të rinj:** Identifikimi dhe fuqizimi i figurave të reja brenda komunitetit (gra dhe të rinj) që gëzojnë besim, për të shërbyer si pika kontakti të qëndrueshme me administratën.

5. Forcimi i partneritetit strategjik me shoqërinë civile

OJF-të duhet të shihen si aleatë për të lehtësuar dialogun, por pa zëvendësuar përgjegjësinë e bashkisë.

- 1.Rolet e qarta:** Lidhja e marrëveshjeve ku OJF-të shërbejnë si lehtësues të besimit dhe edukues, ndërsa bashkia mban përgjegjësinë e plotë për vendimmarrjen dhe zbatimin e investimeve.

2.Rezultate të matshme: Bashkëpunimi të mos mbetet në nivel tryezash, por të matet me indikatorë konkretë: numri i ankesave të zgjidhura, numri i takimeve të përbashkëta dhe investimet e monitoruara bashkërisht.

6. Prioritizimi i infrastrukturës bazë si themel i besimit

Siç dëshmon raporti studimor, asnjë strategji komunikimi nuk do të funksionojë nëse nuk adresohet emergjenca e infrastrukturës.

1.Ndërhyrje të prekshme: Prioritizimi i investimeve në asfaltim, ndriçim, ujë dhe menaxhim mbetjesh. Këto ndërhyrje duhet të jenë të dukshme dhe të shoqërohen me komunikim intensiv publik mbi afatet dhe standardet.

2.Lidhja Investim-Pjesëmarrje: Komuniteti duhet të përfshihet direkt në përcaktimin e rrugëve prioritare për t'u asfaltuar, si dhe në verifikimin final të punimeve. Kjo kthen investimin fizik në një ushtrim të demokracisë lokale dhe ndërton besim.

Referencat

- CRNVO (Centar za razvoj nevladinih organizacija). (2013). Pjesëmarrja e qytetarëve dhe bashkëpunimi mes sektorit civil dhe vetëqeverisjeve lokale në Mal të Zi dhe Shqipëri. Podgorica: Studio Mouse.
- Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. (2014). Census 2014: Banesat dhe popullata – ROME në Shqipëri. https://www.osfa.al/sites/default/files/roma_census_albanian.pdf
- International Budget Partnership. (2008). Open Budget Survey 2008: Albania Country Report. Washington, D.C.:IBP. https://internationalbudget.org/ep-content/uploads/2008/12/cs_albania.pdf
- Këshilli Bashkiak Elbasan. (2020). Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Elbasan. Bashkia Elbasan. <https://elbasani.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/RREGULLORE-E-PERGJITHSHME-E-KESHILLIT-BASHKIAK-EL.pdf>
- Këshilli i Evropës. (2018). Udhëzues mbi Transparencën dhe Pjesëmarrjen Qytetare: Shembuj të praktikave të mira. Tiranë: Këshilli i Evropës & Partners Albania. https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/05/Handbook%20Albania_sqi_WEB.pdf
- Santos, B. de S. (1998). "Participatory Budgeting in Porto Alegre: Toward a Redistributive Democracy". *Politics & Society*, 26(4), 461–510.
- Urban Research Institute. (2005). Participatory budgeting in Albania: Pilot experiences. Urban Research Institute. <https://www.uri.org.al/new/wp-content/uploads/2015/07/Participatory-Budgeting-in-Albania.pdf>

KREU III. RAPORT MONITORIMI

1. Hyrje: Panorama e përgjithshme e qeverisjes vendore

Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrjen lokale nuk është thjesht një kërkesë ligjore, por përbën themelin e një demokracie funksionale dhe parakushtin kryesor për një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Në kontekstin aktual të Shqipërisë, ku reformat e decentralizimit kanë transferuar kompetenca të rëndësishme dhe autonomi financiare tek njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV), roli i qytetarit është transformuar nga një spektator pasiv në një qytetar aktiv që duhet të bashkë-vendosë për komunitetin e tij.

Megjithatë, pavarësisht përmirësimit në kuadrin ligjor, procesi i qeverisjes vendore në Bashkinë Elbasan përballet në praktikë me sfida komplekse. Ky raport monitorimi, i fokusuar në zonën e Rrapishtës (Lagjja "5 Maji"), evidenton një mospërputhje midis detyrimeve ligjore për transparencë, të sanksionuara qartë në Rregulloren e Këshillit Bashkiak Elbsan, dhe realitetit të qasjes në informacion për qytetarët e thjeshtë.

Një vështrim i kujdesshëm mbi infrastrukturën e komunikimit të Bashkisë nxjerr në pah se mjetet ekzistojnë, por funksionaliteti i tyre për transparencë reale mbetet i pjesshëm. Bashkia disponon dhe përdor asete dhe instrumente të rëndësishme për informimin publik, përfshirë Programin e Transparencës (të miratuar konform ligjit), faqen zyrtare të internetit, si dhe ekranin e madh digjital në sheshin "Gensher", i cili mundëson afishimin e njoftimeve dhe publikimeve masive. Megjithatë, monitorimi tregon se këto kanale shpesh nuk përmbushin misionin e tyre primar. Faqja e internetit, e cila duhet të jetë dritarja kryesore e informimit dhe llogaridhënies, ka përditësime sporadike; seksione kyçe të Programit të Transparencës mbeten të pa-azhurnuara prej kohësh, me dokumente strategjike të vjetruara ose hapësira informacioni të paplota aty ku duhet të ishin planet konkrete të investimeve.

Kjo neglizhencë në përditësimin e të dhënave, e kombinuar me mosshfrytëzimin e plotë të mjeteve vizuale si ekranin në qendër për njoftime komunitare, krijon një barrierë të parë informative që e bën edhe më të vështirë përfshirjen e qytetarëve, veçanërisht të atyre nga grupet e marginalizuara.

2. Kuadri ligjor dhe institucional: baza e monitorimit

Për të realizuar një monitorim efektiv dhe objektiv, është e domosdoshme të kuptohet baza ligjore që rregullon marrëdhënien midis qytetarëve dhe pushtetit vendor. Ky kuadër ligjor luan rol të rëndësishëm dhe shërben si tregues për performancën e Bashkisë.

2.1. Kuadri kombëtar: Detyrimet kushtetuese dhe ligjore

Në nivel kombëtar, legjislativi shqiptar ka ndërtuar një bazë ligjore të plotë dhe të mirorganizuar për garantimin e të drejtave qytetare, të cilat bazohen kryesisht në tri ligjet në vijim:

Së pari *Kushtetuta dhe Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"*: Këto akte jo vetëm që sanksionojnë decentralizimin, por e bëjnë të detyrueshme transparencën buxhetore dhe

konsultimin me publikun për çdo vendim madhor. Ato vendosin standardin se pushteti vendor buron nga qytetarët dhe ushtrohet për ta.

Së dyti *Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"*: Ky ligj rregullon në detaje mekanikën e konsultimit. Ai përcakton se konsultimi nuk është një akt formal, por një proces që kërkon kohë dhe përgatitje, duke rekomanduar njoftimin të paktën 20 ditë para zhvillimit të takimeve, për t'i dhënë mundësi qytetarëve të përgatiten.

Së treti *Ligji nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"*: Ky është instrumenti kyç për monitorimin financiar. Nenet 2, 4 dhe 5 të këtij ligji janë gurë themeli për disiplinën fiskale. Ato kërkojnë që buxheti të hartohet në harmoni me nevojat e komunitetit dhe që programet buxhetore afatmesme të jenë objekt i diskutimit publik, duke garantuar se paratë e taksapaguesve shkojnë aty ku ka më shumë nevojë.

2.2. Kuadri lokal: Rregullorja e Këshillit Bashkiak Elbasan

Në nivel lokal, Rregullorja e Këshillit Bashkiak shërben si udhërrëfyes operacional, duke detajuar mekanizmat specifikë për buxhetimin me pjesëmarrje përmes këtyre neneve:

Neni 63 (Roli i Komisionit të Financës): Ky nen i jep Komisionit të Financës, Buxhetit dhe Aseteve Publike një rol filtrues dhe analitik. Projektbuxheti duhet të shqyrtohet paraprakisht nga ky komision, duke u siguruar që prioritetet janë analizuar me kujdes para se të hapen për diskutim publik.

Neni 64 (Informimi dhe Konsultimi): Ky është neni që e përkthen në veprim buxhetimin me pjesëmarrje. Ai detyron hartimin e një kalendarit të qartë dëgjësash (zakonisht tetor-nëntor), specifikimin e saktë të vendit dhe orës, dhe ç'është më e rëndësishmja, detyrimin për të organizuar të paktën një dëgjësë në çdo njësi administrative, për të mos lënë askënd jashtë.

Neni 65 (Dokumentimi dhe Reflektimi): Për të shmangur që konsultimet të mbeten thjesht "fjalë në erë", ky nen garanton që propozimet e qytetarëve të dokumentohen me shkrim dhe të përfshihen në shtojcën për Konsultimin Publik të buxhetit të miratuar, duke krijuar një gjurmë auditi të demokracisë.

Neni 57 (E Drejta e Peticionit): Rregullorja e njeh peticionin si një të drejtë themelore demokratike. Ajo vendos afate të përcaktuara (60 ditë për shqyrtim) dhe detyrimin për njoftim me shkrim, duke i dhënë qytetarëve një mjet të fuqishëm për t'i kërkuar Këshillit Bashkiak të marrë në shqyrtim çështje specifike.

3. Gjetjet e monitorimit: Hendeku midis ligjit dhe realitetit

Pavarësisht këtij kuadri ligjor të pasur, monitorimi i realizuar në terren, me fokus specifik zonën e Rrapishtës, ka zbuluar një realitet tjetër. Janë identifikuar tre shtylla kryesore ku standardi ligjor nuk është përmbushur, duke krijuar një hendek komunikimi dhe besimi midis qytetarëve dhe institucionit.

3.1. Njoftimi Publik dhe Mungesa e Informimit Paraprak

Informimi paraprak përbën një element themelor të çdo procesi gjithëpërfshirës dhe është kusht i domosdoshëm për pjesëmarrjen e komunitetit. Të dhënat e monitorimit sugjerojnë se mekanizmat aktualë të njoftimit publik, ndonëse ekzistues, nuk arrijnë gjithmonë të adresojnë në mënyrë të plotë nevojat e grupeve vulnerabël, veçanërisht në lagjet e marginalizuara.

Afatet dhe ndryshimet në njoftime. Një nga sfidat e evidentuara lidhet me respektimin e afateve ligjore për njoftimin e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje. Në disa raste, njoftimet janë publikuar me vonesë, ndërsa ndryshimet e datave të takimeve janë bërë afër kohës së zhvillimit të tyre. Kur këto ndryshime nuk shoqërohen me një komunikim të përsëritur dhe të qartë, ato mund të krijojnë paqartësi dhe të ndikojnë negativisht në mundësinë e pjesëmarrjes së banorëve. Kjo situatë nënvizon rëndësinë e respektimit të afateve të rekomanduara ligjore, si dhe të komunikimit të qëndrueshëm.

Përrjashtimi digjital dhe mungesa e informacionit fizik. Praktikrat aktuale të njoftimit mbështeten kryesisht në faqen zyrtare të bashkisë dhe në rrjetet sociale. Ndërkohë, për banorët e lagjeve si Rrapishta, ku aksesimi në internet dhe aftësitë digjitale mund të jenë të kufizuara, këto kanale nuk janë gjithmonë të mjaftueshme. Mungesa e informacionit fizik në terren, si posterë, fletëpalosje apo takime informuese të dedikuara, kufizon qasjen në informacion dhe ul mundësinë e përfshirjes së tyre në proces. Kjo tregon nevojën për një kombinim më të balancuar të kanaleve digjitale dhe atyre tradicionale, në mënyrë që informacioni të jetë i aksesueshëm për të gjithë.

3.2. Kanale Komunikimi jo-funksionale dhe mungesa e llogaridhënies

Një nga gjetjet më të rëndësishme të këtij raporti është mosfunksionimi i plotë i kanaleve institucionale të komunikimit, çka bie ndesh me Nenin 19 të Rregullores.

Fiktiviteti i kontakteve zyrtare: Lista zyrtare e e-maileve të 51 anëtarëve të Këshillit Bashkiak (Mandati 2023-2027), e cila është publikuar për qytetarët si mjet kontakti, rezulton të jetë jofunksionale. Tentativat për të komunikuar përmes këtyre e-maileve kanë dështuar pasi asnjë prej e-maileve Emër.Mbiemër@këshilli.elbasani.gov.al nuk është funksional (<https://elbasani.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/Perberja-e-KB-2023.pdf>).

Zgjidhja informale si zgjidhje e vetme: Për të realizuar një veprim të thjeshtë si dërgimi i një peticioni, monitoruesit e LRER janë detyruar të ndjekin rrugë informale, duke siguruar adresën private e-maili përmes komunikimeve të mëparshme me disa anëtarë të këshillit. Kjo situatë është e papranueshme në një administratë publike, pasi cenon rëndë barazinë në akses. Qytetarët që nuk kanë "komunikime të mëparshme" mbeten efektivisht pa zë.

Kthimi formal i përgjigjeve pa mekanizma vijues, në kundërshtim me kuadrin ligjor: Monitorimi i procesit të buxhetimit me pjesëmarrje në Bashkinë Elbasan evidenton se kthimi i përgjigjeve institucionale ndaj kërkesave të artikuluara nga qytetarët mbetet kryesisht formal dhe pa përmbajtje substanciale. Konkretisht, peticioni i paraqitur nga banorët romë dhe egjiptianë të lagjes "Rrapishtë" drejtuar Këshillit Bashkiak Elbasan ka marrë një përgjigje zyrtare nga Zëvendëskryetari i Bashkisë, por analiza e kësaj përgjigjeje tregon mungesë të informacionit mbi

hapat e mëtejshëm të ndjekjes së kërkesës, mungesë të afateve të qarta dhe mungesë të masave konkrete që do të ndërmerren. Kjo praktikë nuk përputhet me detyrimet e përcaktuara në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, veçanërisht nenin 15, i cili parashikon të drejtën e qytetarëve për informim dhe transparencë, si dhe nenin 18, që detyron organet e vetëqeverisjes vendore të krijojnë mekanizma funksionalë për pjesëmarrjen dhe ndikimin e qytetarëve në vendimmarrje. Në këtë kuadër, monitorimi konstaton se kthimi i përgjigjeve nga autoritetet vendore nuk garanton përmbushjen e standardeve ligjore për llogaridhënie dhe transparencë, duke e reduktuar procesin në një akt administrativ pa efekt real në vijimin e politikave publike.

3.3. Pas-Konsultimi dhe Efektiviteti i Ulët i Pjesëmarrjes

Edhe kur konsultimet ndodhin, ato shpesh rezultojnë të jenë formale pa impakt real në jetën e komunitetit.

Pjesëmarrje simbolike: Pjesëmarrja e komuniteteve romë dhe egjiptiane llogaritet në përqindje shumë të ulëta, e cila është pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së informimit dhe besimit.

Premtime pa datë: Gjatë takimeve advokuese në lagjen Rrapishtë, banorët morën siguri verbale se prioritetet e tyre kryesore do të merrnin vëmendje. Ky premtime u pasua edhe me një dokument zyrtar, (Procesverbal dhe listë prezencë e konsultimit “Zëri i Komunitetit :Fuqizimi i Romëve dhe Egjiptianëve për vendimmarrje lokale” – Bashkia Elbasan) Megjithatë, konsultimi nuk u pasua me një vendim këshilli apo datë fillestare për ndërhyrje në terren.

Pjesëmarrja e kufizuar e ekspertizës: Konsultimet shpesh realizohen vetëm me përfaqësues të niveleve politike, por jo të drejtorive përkatëse në bashki. Problematikat e komunitetit janë komplekse (infrastrukturë, legalizime, shërbime sociale) dhe kërkojnë praninë e drejtorive të tjera (Urbanistikë, Shërbime Publike) për të dhënë përgjigje kompetente dhe zgjidhje reale.

Mospërkthimi i pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje financiare: Një gjetje thelbësore e monitorimit lidhet me hendekun e vazhdueshëm ndërmjet procesit formal të buxhetimit me pjesëmarrje dhe përfshirjes reale të prioritetëve të qytetarëve në vendimmarrjen financiare të Bashkisë Elbasan. Edhe pse procesi zhvillohet në përputhje me procedurat formale – përfshirë konsultimet me qytetarët, identifikimin dhe votimin e prioritetëve – mungon një mekanizëm i qartë dhe i strukturuar që shpjegon mënyrën se si këto prioritete përzgjidhen, filtrohen dhe integrohen në fazat pasuese të planifikimit. Si rrjedhojë, prioritetet e shprehura nga komuniteti i lagjes “Rrapishtë” nuk rezultojnë të gjurmueshme në dokumentacionin përfundimtar të procesit. Gjetjet mbështeten gjithashtu në zhvillimin e fokus-grupeve të vogla me banorë të lagjes, ku është evidentuar qartë se ky prioritet është artikuluar dhe votuar në mënyrë të përsëritur ndër vite, por vijon të mbetet pa përgjigje konkrete dhe pa financim.

Kjo situatë bie në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 139/2015, i cili garanton të drejtën e qytetarëve për ndikim real në hartimin e buxheteve vendore, si dhe me Ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, që parashikon se proceset konsultuese duhet të kenë ndikim të dokumentuar në vendimmarrje. Monitorimi tregon se, në praktikë, buxhetimi me pjesëmarrje në Bashkinë Elbasan funksionon kryesisht si një mekanizëm konsultimi formal, i cili nuk shoqërohet me një mekanizëm të qartë dhe të strukturuar që të sqarojë mënyrën e përzgjedhjes,

renditjes dhe kalimit në zbatim të prioriteteve të propozuara nga komuniteti. Mungesa e një kalendari orientues dhe e kriterëve transparente për trajtimin e prioriteteve në raport me zonat dhe fazat e tjera të ndërhyrjes e bën procesin të paqartë për qytetarët dhe kufizon efektivitetin e tij në adresimin e nevojave të komuniteteve vulnerabël, përfshirë romët dhe egjiptianët e lagjes “Rrapishtë”.

4. Rekomandime strategjike për përmirësimin e procesit

Për të transformuar këtë situatë dhe për të kaluar nga një pjesëmarrje formale drejt një ndikimi real në vendimmarrje, propozohen masat e mëposhtme konkrete:

1. Funkcionalizimi i komunikimit zyrtar dhe kthimi i përgjigjeve brenda afateve ligjore

Bashkia Elbasan dhe Këshilli Bashkiak duhet të garantojnë funksionalitetin e plotë të kanaleve zyrtare të komunikimit, përfshirë aktivizimin dhe publikimin e adresave zyrtare të e-mailit për të gjithë këshilltarët bashkiakë. Paralelisht, duhet të monitorohet respektimi i afateve ligjore për kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave dhe peticioneve qytetare, duke siguruar që përgjigjet zyrtare të përmbajnë hapa konkretë, institucione përgjegjëse dhe afate të qarta, në përputhje me nenin 15 dhe nenin 18 të Ligjit nr. 139/2015.

2. Zbatimi efektiv i Nenit 57 për trajtimin e peticioneve

Çdo peticion i protokolluar duhet të ndjekë automatikisht rrugën institucionale të parashikuar nga neni 57 i Regullores së Këshillit Bashkiak, Elbasan duke iu përcjellë për shqyrtim Komisioneve të Përhershme përkatëse dhe duke u përfshirë detyrimisht në rendin e ditës së mbledhjes pasuese të Këshillit Bashkiak. Bashkia dhe Këshilli duhet të njoftojnë zyrtarisht parashtruesit e peticionit për fazat e shqyrtimit dhe vendimmarrjes, duke forcuar transparencën dhe llogaridhënien institucionale.

3. Lidhja e buxhetimit me pjesëmarrje me vendimmarrjen financiare dhe transparencën e zbatimit

Bashkia Elbasan duhet të krijojë një mekanizëm ndjekës për buxhetimin me pjesëmarrje, i cili të dokumentojë qartë trajtimin e prioriteteve të qytetarëve në fazën e hartimit të Planit Afatmesëm të Investimeve dhe buxhetit vjetor, në përputhje me nenin 16 të Ligjit nr. 139/2015. Për prioritetet e miratuara dhe të financuara, rekomandohet publikimi i një Kalendari të Zbatimit, ku të specifikohen fondet e alokuara, afatet e fillimit dhe përfundimit të punimeve, duke u dhënë qytetarëve një mjet konkret për ndjekjen e zbatimit.

4. Forcimi i konsultimit publik përmes informimit gjithëpërfshirës

Në zbatim të Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Bashkia Elbasan duhet të sigurojë që njoftimet për dëgjesat publike të bëhen në kohë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, të paktën 20 ditë përpara. Strategjia e informimit duhet të jetë hibride, duke kombinuar njoftimet online me kanale alternative si posterë në lagje, njoftime në qendrat komunitare dhe takime direkte me komunitetin, në mënyrë që proceset konsultuese të arrijnë edhe qytetarët pa akses në internet.

5. Përfundime

Analiza e detajuar e situatës në Bashkinë Elbasan na çon në konkluzionin që kuadri ligjor ekzistues ofron baza të shëndosha dhe mekanizma të mjaftueshëm për të garantuar pjesëmarrjen qytetare. Megjithatë, krahas ligjeve dhe rregulloreve, nevojitet edhe vullneti për ta zbatuar atë.

Kalimi nga pjesëmarrja formale drejt ndikimit real kërkon më shumë sesa thjesht ndryshime procedurale; ai kërkon një ndryshim kulturor në mënyrën se si institucioni e sheh qytetarin: jo si një pengesë, por si një partner në qeverisje.

KREU IV: 12 PRAKTIKA TË MIRA PËR PËRFSHIRJE DHE ADVOKIM KOMUNITAR NË LAGJEN “RRAPISHTË”, ELBASAN

Ky raport dokumenton 12 praktika të suksesshme të zbatuara në Lagjen “Rrapishtë” Elbasan, për të përmirësuar përfshirjen qytetare, të drejtat dhe komunikimin midis komunitetit dhe autoriteteve vendore. Këto praktika u zhvilluan në përgjigje të mungesës së disa shërbimeve bazë, si mekanizma efektivë të përfshirjes qytetare. Ato vlerësohen si instrumente që kontribuojnë në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrje publike.

Lagja “5 Maji” është një zonë informale me 2372 banorë (rreth 539 familje) nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane, me të ardhura të ulëta dhe kufizime në aksesin e shërbimeve publike. Mungesa e rrugëve, ndriçimit, kanalizimit dhe mekanizmave të përfshirjes qytetare kërkonte një qasje të strukturuar për të ndryshuar dinamikën ekzistuese.

12 Praktikrat e Mira: Pse dhe Si

Ndërsa organizojmë praktikrat e përfshirjes dhe advokimit komunitar, duhet të krijojmë një rrugë të qartë për të mbështetur zbatimin e tyre. Përshkrimi i hollësishëm i praktikave është thelbësor për konsistencën në zbatim dhe për të lejuar aktorë të tjerë të adaptojnë këto praktika në kontekste të tjera nëse nevojitet. Ai krijon një referencë të përbashkët për të kuptuar qëllimin, mënyrën e implementimit, burimet e nevojshme, përgjegjësitë dhe afatet. Pa një përshkrim të qartë, mund të lindin interpretime të ndryshme, të dilet nga konteksti ose të lindin barrierat e zbatueshmërisë së tyre.

Ndërkohë që hartojmë një paketë praktikash pozitive, një qasje e konsistencës dhe koherencës në komunikim është kritike për të ndihmuar të tjerët të besojnë në integritetin dhe transparencën e procesit.

Dialogu i vazhdueshëm dhe llogaridhënia janë motorët e qëndrueshmërisë në demokraci. Së pari, dialogu siguron një mekanizëm të vlerësimit të progresit, të raportimit të rezultateve dhe të përmirësimit të vazhdueshëm. Së dyti, pa një kuadër të qartë për llogaridhënie, mbetja në angazhime të paqarta dhe mungesa e monitorimit apo komunikimit mund të çojnë në vonesa, mungesë rezultatesh dhe mosbesim nga ana e komunitetit. Prandaj, një strukturë e fortë e dialogut dhe një sistem i raportimit të vijueshmërisë së procesit janë thelbësorë për të garantuar që propozimet e komunitetit të merren në konsideratë, të monitorohen dhe të konkretizohen në veprim.

Më poshtë parashtrihen 12 praktika pozitive, fillimisht në formë të shkurtuar e më pas të zgjeruar, dhe ku nevojitet, shoqërohen edhe me shpjegime si janë përdorur apo rekomandime shtesë për zbatueshmërinë e tyre nga aktorë dhe kontekste të tjera, sipas nevojës.

1. Qasje e Strukturuar për Informim dhe Ndërgjegjësim Qytetar

- Pse: Për të rritur transparencën, njohuritë mbi të drejtat dhe angazhimin e banorëve.
- Si: Organizimi i takimeve me agjendë të qartë, materiale vizuale dhe një përmbledhje pas takimit. Përmbajtja dhe materialet u përshtaten në mënyrë të thjeshtëzuar sipas nivelit të komunitetit që po ndërhyjmë, duke përfshirë gjuhë të thjeshtë, ilustrime dhe variante të informacionit në nivel të ndryshëm të detajeve.

2. Krijimi dhe fuqizimi i grupit të Advokimit Komunitar

- Pse: Për të krijuar një strukturë përfaqësuese që artikulon zërin e komunitetit.
- Si: Përzgjedhja e anëtarëve u realizua në vijim të takimeve informuese-ndërgjegjësuere, dhe u pasua me trajnime për aftësi mbi proceset vendimmarrëse, advokacinë dhe lobimin

3. Hartimi, pilotimi dhe plotësimi i pyetësorit

- Pse: Për të mbledhur të dhëna empirike të strukturuar mbi nevojat dhe prioritetet e banorëve.
- Si: Zhvillimi i një pyetësori të thjeshtë, pilotimi i tij dhe shpërndarja me ndihmën e grupit të advokimit komunitar.

4. Dokumentimi i kërkesave prioritare

- Pse: Për të krijuar një bazë të dokumentuar të nevojave për t'ua paraqitur autoriteteve.
- Si: Përpilimi i një dokumenti zyrtar me prioritetet e identifikuara dhe dorëzimi e protokollimi i tij në Bashkinë Elbasan

5. Aktivizimi i Grupit Komunitar për Pjesëmarrje Efektive në Buxhetimin me Pjesëmarrje

- Pse: Për të siguruar që burimet të shpërndahen në përputhje me nevojat e komunitetit.
- Si: Përfshirja e përfaqësuesve të grupit në diskutimet për buxhetin lokal.

6. Forcimi i komunikimit institucional

- Pse: Për të paraqitur direkt kërkesat dhe për të negociuar zbatimin e tyre.
- Si: Organizimi i takimeve formale me paraqitje të dokumentit të prioritetëve përmes dialogut mes palëve.

7. Advokimi si mjet ndikimi në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak

- Pse: Për të lobuar përmes mbështetjes politike dhe koordinimit ndërinstitucional.

- Si: Kërkesë për paraqitje të strukturuar të çështjeve të lagjes “Rrapishtë” në seancën e këshillit bashkiak dhe përfshirja e çështjeve prioritare të lagjes në mbledhjen e aprovimit të buxhetit për vitin 2026

8. Përdorimi i peticionit si mekanizëm ligjor për të ndikuar në vendimmarrje

- Pse: Për të demonstruar masivisht mbështetjen e komunitetit për kërkesat e parashtruara.
- Si: Hartimi dhe nënshkrimi i një peticioni dhe dorëzimi zyrtar i tij.

9. Lobimi si mjet për ndikim në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak

- Pse: Për të ndikuar direkt në vendimmarrje lidhur me alokimin e burimeve për lagjen “Rrapishtë”.
- Si: E-mail në grup me informacion dhe kërkesë për përfaqësim dhe paraqitje e propozimeve konkrete.

10. Mekanizmi i dialogut të vazhdueshëm për llogaridhënie dhe transparencë

- Pse: Për të krijuar mekanizma të qëndrueshëm komunikimi dhe monitorimi.
- Si: Takime periodike me autoritetet vendore dhe kërkesë për raportime të rregullta mbi përparimin e vendimmarrjes apo punimeve.

11. Takim teknik për implementimin e prioriteteve të komunitetit me përfaqësuesit e bashkisë

- Pse: Për të diskutuar në mënyrë të fokusuar dhe teknike zbatimin e kërkesave, duke shfrytëzuar kanalet administrative të drejtpërdrejta.
- Si: Organizimi i një takimi koordinues në zyrën e zëvendëskryetarit me praninë e me LRER dhe Grupin e Advokimit për çështje infrastrukture për të parë dhe monitoruar sesi janë reflektuar prioritetet e paraqitura.

12. Përdorimi i multimedias dhe rrjeteve sociale si mjet për ndërgjegjësim publik dhe presion pozitiv

- Pse: Për të rritur presionin publik dhe për të siguruar transparencë.
- Si: Hartimi, postimi dhe shpërndarja e videove, fotove dhe tekstit shpjegues me kushtet e rrugëve të lagjes “Rrapishtë”.

Praktika 1: Qasje e strukturuar për informim dhe ndërgjegjësim qytetar

Kjo praktikë u implementua për të adresuar mungesën e informacionit dhe ndërgjegjësimin në komunitetin e Lagjes “Rrapishtë” në lidhje me të drejtat e banorëve, mekanizmat e buxhetimit lokal dhe mundësitë e përfshirjes qytetare. Qëllimi kryesor ishte krijimi i një baze njohurish dhe

forcimi i kapaciteteve të komunitetit për t'u angazhuar në dialog me institucionet në nivel vendimmarrjeje lokale.

U organizuan takime me agjendë të paracaktuar, të shpërndara në një periudhë dymujore. Takimet u zhvilluan në ambiente të arritshme fizike dhe në orare të përshtatshme për banorët. U përdorën mjete vizuale (prezantime) dhe materiale të shkruara të adaptuara për nivele të ndryshme edukimi. Pas çdo takimi, u bë përmbledhje me pikat kyçe dhe u shpërndanë informacione kontakti.

Rezultatet

- U informuan pjesëmarrësit.
- U formua një bazë e qëndrueshme për proceset e advokimit të mëvonshëm.
- U dokumentuan dhe u sistematizuan pyetjet dhe shqetësimet kryesore të komunitetit.

Kjo praktikë e takimeve informuese-ndërgjegjësuere kontribuoi në:

- Ngritjen e kapaciteteve të banorëve për të identifikuar dhe artikuluar nevojat e tyre.
- Krijimin e mekanizmave fillestare të transparencës dhe komunikimit me autoritetet.
- Hedhjen e themeleve për formimin e Grupit të Advokimit Komunitar.

Rekomandime për zbatim në kontekste të ngjashme

- Përshtatja e materialeve me profilin e komunitetit (p.sh., përdorimi i gjuhës së thjeshtë).
- Angazhimi i figurave me ndikim në nivel lokal si liderë në procesin e informimit.
- Sigurimi i vazhdimësisë së takimeve për të ruajtur ritmin dhe ndërgjegjësimin.

Kjo praktikë vlerësohet si hap themelor për çdo iniciativë të ngjashme që synon përfshirjen e komuniteteve të marginalizuara në proceset vendimmarrëse.

Praktika 2: Krijimi dhe fuqizimi i Grupit të Advokimit Komunitar

Krijimi i GAK u konsiderua si parakusht thelbësor për të krijuar një strukturë të qëndrueshme përfaqësuese në Lagjen “Rrapishtë”. Në mungesë të mekanizmave formale për përfshirje, komuniteti kishte nevojë për një mekanizëm të pranueshëm dhe funksional që të mund të artikulonte kolektivisht nevojat dhe kërkesat e banorëve. Ky grup synon të shërbejë si një ndërmjetës i besuar midis komunitetit dhe autoriteteve vendore, duke kontribuar në zgjidhjen e problemeve strukturore të përjashtimit nga vendimmarrja lokale dhe mungesës së përfaqësimit.

Procesi i përzgjedhjes u bazua në parime të gjithëpërfshirjes dhe transparencës. Në vijim të takimeve informuese, u identifikuan banorë me angazhim dhe influencë pozitive në komunitet. Për të siguruar përfaqësimin e gjithë komunitetit, u morën parasysh faktorët e gjinisë, moshës dhe shpërndarjes gjeografike në lagje. Përzgjedhja u krye nëpërmjet konsultimeve të hapura, ku banorët propozuan dhe miratuan kandidatët.

U organizuan katër seanca trajnimi intensive, të hartuara më qëllim për të përforcuar aftësitë e nevojshme për advokim efektiv. Programi i trajnimit përfshiu:

1. Të Drejtat qytetare dhe përfshirja në vendimmarrje

Si të ndërtohen argumente bindëse të bazuara në fakte, si të hartohen dokumente zyrtare dhe si të paraqiten kërkesa në mënyrë të strukturuar.

2. Procesi i buxhetimit vendor dhe prioritetet komunitare

Njohja e kompetencave të bashkisë, proceseve buxhetore dhe mënyrave për të ndikuar në vendimmarrje.

3. Advokimi dhe lobimi

Komunikimi me autoritetet, mediat dhe palët e interesit, përdorimi i gjuhës së duhur dhe kanalet formale.

4. Monitorimi i politikave publike

Mbledhja e të dhënave, protokollimi i kërkesave dhe monitorimi i zbatimit të marrëveshjeve.

Trajnimet u zhvilluan nga ekspertë të LRER- së.

Rezultatet

Formalizimi i Grupit të Advokimit Komunitar solli rezultate të prekshme. Grupi koordinoi me sukses mbledhjen e të dhënave përmes pyetësorëve, mori pjesë në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje në Rajonin Nr. 6, dhe organizoi takimet e para me përfaqësues të bashkisë si edhe të Këshillit Bashkiak.

Grupi u bë zëri i njësuar i komunitetit, duke ndikuar në proceset vendimmarrëse. Autoritetet filluan ta njihnin si një palë serioze dhe legjitime, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien. Përmes këtij grupi, u arrit të viheshin në plan të parë çështje kryesore si mungesa e infrastrukturës dhe shpërndarja e buxhetit.

Sfidat dhe Përballimi i Tyre

Sfida kryesore ishte mbajtja e motivimit të anëtarëve, veçanërisht në fazën fillestare. Kjo u kapërcye duke organizuar aktivitete të vogla, por të suksesshme, që sollën rezultate të shpejta. Një sfidë tjetër ishte mungesa e përvojës administrative, e cila u kompensua me trajnime të vazhdueshme dhe mbështetje teknike nga organizata LRER.

Rekomandime për zbatim në kontekste të ngjashme

1. Përzgjedhja e anëtarëve duhet të bëhet nëpërmjet konsultimeve të hapura për të siguruar përfaqësim të gjerë dhe pranimin e tyre nga i gjithë komuniteti.
2. Trajnimet nevojitet të fokusohen jo vetëm në aspekte teorike, por edhe në simulime praktike të negociatave dhe komunikimit.
3. Grupi të dalë me një strukturë të thjeshtë, të qartë, dhe të finalizuar me shpërndarje të detyrave.

4. Grupi duhet të integrohet në struktura zyrtare komunitare të bashkisë për të garantuar vazhdimësinë, si për shembull, ndërlidhës komunitarë.

Kjo praktikë demonstroi se një grup i fuqizuar dhe i organizuar mund të transformojë ankesat e shpërndara në kërkesa të vlefshme, duke kontribuar në një dinamikë më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse midis komunitetit dhe institucioneve.

Praktika 3: Hartimi, pilotimi dhe plotësimi i pyetësorit

Kjo praktikë u zhvillua me qëllimin primar të mbledhjes së të dhënave empirike të strukturuar mbi nevojat dhe prioritetet e banorëve të Lagjes "Rrapishtë". Në një kontekst ku mungonte informacion sistematik për këto çështje, pyetësi shërbeu si mjet themelor për të grumbulluar informacion sasior dhe cilësor mbi problemet e lagjes, duke mundësuar një qasje të bazuar në evidenca dhe fakte për advokim dhe lobim.

Procesi i hartimit të pyetësorit u bazua në një strukturë të ndërtuar me katër blloqe kryesore përmbajtësore. Blloku i parë përfshinte të dhëna demografike themelore si mosha, gjinia, niveli arsimor dhe statusi i punësimit. Blloku i dytë fokusohet në njohuritë e përgjithshme mbi përfshirjen në qeverisje vendore, ndërsa blloku i tretë eksploronte përvojat konkrete të përfshirjes dhe bashkëpunimit me institucionet. Blloku i fundit ishte i dedikuar identifikimit të nevojave dhe prioritetëve specifike të komunitetit.

Para se të implementohej në shkallë të gjerë, pyetësi iu nënshtrua një faze pilotimi me 15 banorë. Kjo fazë shërbeu për të vlerësuar kuptueshmërinë e pyetjeve, për të matur kohën e nevojshme për plotësim (që rezultoi 15-20 minuta) dhe për të përshtatur formulimet në bazë të sugjerimeve të marra gjatë pilotimit. Pilotimi doli jashtëzakonisht i dobishëm për të përmirësuar kuptueshmërinë dhe përshtatshmërinë e instrumentit.

Faza e implementimit përfshiu shpërndarjen e pyetësorit nga anëtarët e trajnuar të Grupit të Advokimit Komunitar për regjistrim digjital të të dhënave nëpërmjet formularit Google, ku u mbledhën 167 pyetësorë të plotësuar nga banorët.

Rezultatet e nxjerra nga të dhënat e mbledhura ofruan një pasqyrë të detajuar të situatës. Profili demografik tregoi një shpërndarje të gjerë moshore nga 18 deri në 85 vjeç dhe shpërndarja sipas gjinisë ishte e balancuar. Një gjetje shqetësuese ishte niveli shumë i ulët arsimor, ku 54% e të anketuarve nuk kishin përfunduar asnjë nivel shkollor dhe 29% kishin vetëm shkollën fillore. Gjithashtu, u konstatua një shkallë e lartë papunësie (40.1%) dhe varësi të konsiderueshme nga asistenca sociale (26.9%).

Gjetjet kryesore nga analiza e përgjigjeve treguan se 89% e banorëve identifikuan mungesën e kanalizimit si problem kryesor, ndërsa 85% vlerësuan rrugët e pashtuara si problem tepër serioz. Një tregues i rëndësishëm ishte se vetëm 5.4% e të anketuarve raportuan se kanë marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga bashkia, dhe 62% raportuan mungesë informacioni si pengesë kryesore për pjesëmarrje.

Të dhënat e mbledhura shërbyen si bazë solide për zhvillimin e Dokumentit të Prioriteteve që iu paraqit bashkisë, identifikimin e fushave kryesore për lobim dhe vërtetimin zyrtar të nevojave të komunitetit me statistikat përkatëse. Në këtë mënyrë, pyetësi arriti të transformojë ankesat e shpërndara dhe të pastruara në të dhëna të sistematizuara, duke mundësuar një qasje të bazuar në evidenca për advokimin e të drejtave të komunitetit dhe duke forcuar pozicionin e tyre në dialogun me autoritetet vendore.

Praktika 4: Dokumentimi i kërkesave prioritare

Krijimi i një baze të dokumentuar të nevojave të komunitetit ishte një hap thelbësor për të transformuar ankesat e banorëve të shpërndara në kërkesa të strukturuar dhe të vlefshme. Ky dokument synonte të evidentonte nevojat reale dhe urgjente të banorëve, duke ofruar një bazë informacioni për proceset e advokimit dhe vendimmarrjes lokale. Qëllimi ishte të krijohej një instrument zyrtar që do të shërbente si referencë e pamohueshme në dialogun me autoritetet vendore.

Procesi i dokumentimit filloi me analizën sistematike të të dhënave të mbledhura përmes pyetësorëve dhe takimeve me komunitetin. U identifikuan gjashtë probleme kryesore bazuar në shpeshhtësinë e përmendjes dhe rëndësinë e përcaktuar nga banorët. Çdo problem u detajua me përshkrimin e ndikimit të tij specifik në jetën e përditshme të komunitetit.

Dokumenti përfundimtar u strukturua në mënyrë që të përfshinte:

- Prezantimin e kontekstit dhe metodologjisë së punës
- Renditjen e prioriteteve me justifikimet përkatëse
- Specifikimin e kërkesave konkrete për zgjidhje
- Referencat e qarta nga procesi konsultativ me komunitetin

Dokumenti u dorëzua zyrtarisht në Bashkinë e Elbasanit me një proces protokollimi të regjistruar, duke përfshirë marrjen e një numri reference zyrtare. Dorëzimi u shoqërua nga një delegacion i përbërë nga anëtarë të Grupit të Advokimit Komunitar dhe përfaqësues të organizatës LRER, të cilët paraqitën personalisht dokumentin dhe ofruan shpjegime shtesë për përmbajtjen e tij.

Dokumenti i Kërkesave Prioritare arriti të:

- Sistematizojë dhe renditë në mënyrë hierarkike nevojat e komunitetit
- Ofrojë një bazë të dokumentuar për negociatat me autoritetet
- Krijojë një referencë të qëndrueshme për monitorimin e zbatimit të kërkesave
- Forcojë pozicionin e komunitetit në dialogun me institucionet

Ky dokument shërbeu si kornizë bazë për të gjitha aktivitetet e mëvonshme të advokimit, duke mundësuar që komuniteti të paraqiste kërkesat e tij në mënyrë të qartë, të dokumentuar dhe të vërtetueshme. Ai transformoi dialogun nga një shkëmbim i paformuar ankimesh në një proces të strukturuar negociatash bazuar në evidenca dhe të dhëna konkrete.

Procesi i dokumentimit dhe dorëzimit zyrtar ndihmoi në institucionalizimin e kërkesave të komunitetit, duke i bërë ato një pjesë zyrtare të agjendës së bashkisë dhe duke krijuar një bazë të qëndrueshme për ndjekjen e zbatimit të tyre në kohë.

Praktika 5: Aktivizimi i Grupit Komunitar për pjesëmarrje efektive në Buxhetimin me Pjesëmarrje

Ky proces u zhvillua me qëllim të qartë të garantimit të shpërndarjes së burimeve buxhetore në përputhje të plotë me nevojat e vërteta të komunitetit. Përfshirja direkte e përfaqësuesve të GAK në diskutimet buxhetore synonte të siguronte që zëri i banorëve të merrej në konsideratë në vendimmarrjen financiare, dhe të sillte procesin buxhetor më afër njerëzve.

Në takimin e buxhetimit për Rajonin 6, për herë të parë morën pjesë aktive shumë anëtarë të Grupit të Advokimit Komunitar. Përfaqësuesit e komunitetit ishin përgatitur përmes seancave trajnuese për të kuptuar proceset buxhetore. Gjatë takimit zyrtar, anëtarët e grupit morën pjesë aktivisht duke marrë mikrofonin dhe duke paraqitur argumente të dokumentuara për çështjet kritike për lagjen e tyre.

Në fjalën e tyre, përfaqësuesit e komunitetit, burra dhe gra, folën me vendosmëri për katër prioritetet kryesore të identifikuar nga pyetësori. Ata theksuan nevojën për asfaltim dhe mirëmbajtje të rrugëve kryesore dhe degëzuese nëpër lagje, duke shpjeguar se gjendja e tanishme e rrugëve pengon jetën e përditshme të banorëve. Një tjetër çështje e rëndësishme që u ngrit ishte instalimi i sistemit të ndriçimit në të gjitha rrugët e lagjes, me argumentin se mungesa e ndriçimit krijon pasiguri dhe kufizon lëvizjen e banorëve gjatë natës.

Përfaqësuesit e komunitetit paraqitën me detaje edhe nevojën për zgjidhje urgjente për sistemin e kanalizimit dhe ujësjellësit, duke shpjeguar se kjo çështje ka ndikim direkt në shëndetin dhe mirëqenien e banorëve. Gjithashtu, u theksua edhe nevoja për rikonstruksion dhe pajisje të shkollës për fëmijët e lagjes, duke argumentuar se investimet në arsim janë thelbësore për të ardhmen e komunitetit.

Çdo kërkesë u shoqërua me të dhëna konkrete dhe me shpjegime të hollësishme për ndikimin e saj në cilësinë e jetesës së banorëve. Kjo praktikë demonstroi se buxhetimi me pjesëmarrje nuk është thjesht një mekanizëm teknik, por një mjet i fuqishëm për drejtësi sociale dhe fuqizim komunitar, duke mundësuar që burimet publike të shpërndahen në mënyrë më efektive dhe të drejtë.

Praktika 6: Forcimi i komunikimit institucional

Për të paraqitur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe negociuar mbi zbatimin e kërkesave të komunitetit në nivel të lartë vendimmarrës, u organizua një takim advokues me zëvendëskryetarin e Bashkisë Elbasan. Në një kontekst ku mungonte komunikimi institucional dhe komuniteti kishte vështirësi në arritjen e vëmendjes së autoriteteve, ky takim përfaqësonte një mundësi të rëndësishme për të krijuar një kanal të drejtpërdrejtë komunikimi. Qëllimi ishte të kapërcehej tradita e ankesave të pashprehura dhe të krijohet një mekanizëm formal për dialog dhe ndjekje të kërkesave.

Procesi u organizua nëpërmjet një metodologjie të strukturuar dhe të përgatitur me kujdes. Fillimisht, u përdor Dokumenti i Prioriteteve si dokument zyrtar i bazuar në të dhënat e mbledhura nga pyetësorët dhe takimet me komunitetin, ku u identifikuan disa prioritete kryesore si asfaltimi i rrugëve, ndriçimi publik, kanalizimet dhe përmirësimi i kushteve të shkollës. Takimi u zhvillua në Qendrën Komunitare, me pjesëmarrjen e zëvendëskryetarit të bashkisë, anëtarëve të stafit teknik, përfaqësuesve të organizatës LRER dhe banorëve aktivë të komunitetit si edhe shumë banorëve të tjerë. Gjatë takimit, përfaqësuesit e komunitetit prezantuan çështjet duke përdorur fakte dhe evidenca, duke theksuar ndikimin e problemeve në jetën e përditshme dhe duke kërkuar zgjidhje konkrete.

Rezultatet e takimit ishin të prekshme. Zëvendëskryetari i bashkisë u angazhua për të dërguar inxhinierë për vlerësimin e gjendjes së rrugëve dhe kanalizimeve, si dhe për të përfshirë kërkesat në planin e investimeve për vitin 2026. Përmes këtij takimi u krijua një model i rëndësishëm për dialog të drejtpërdrejtë midis komunitetit dhe bashkisë.

Përdorimi i kësaj praktike tregoi se angazhimi i drejtpërdrejtë me vendimmarrësit mund të çojë në rezultate të prekshme, veçanërisht kur bazohet në dokumentim të fortë dhe përgatitje të mirë. Suksesi i takimit varet nga vazhdimësia e ndjekjes dhe aftësia e komunitetit për të ruajtur presionin konstruktiv. Kjo qasje mund të ripërdoret në komunitete të tjera me sfida të ngjashme, duke u bazuar në të njëjtat parime të përgatitjes, dokumentimit dhe negociimit.

Për të garantuar ripërdorimin efektiv të kësaj praktike, rekomandohet përdorimi i të dhënave të dokumentuara për të forcuar argumentimin, përgatitja e materialeve vizuale për të ilustruar problematikat dhe angazhimi i të gjitha palëve të interesuara në procesin e dialogut. Kjo praktikë demonstroi se duke krijuar hapësira formale për dialog dhe duke paraqitur kërkesat në mënyrë të strukturuar, komuniteti mund të arrijë një ndikim të dukshëm në vendimmarrjen lokale.

Praktika 7: Advokimi si mjet ndikimi në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak

Fuqizimi i Grupit të Advokimit solli disa forma të ndikimit në vendimmarrje, një prej të cilave ishte takim advokues me përfaqësues të Këshillit Bashkiak Elbasan. Përmes këtij takimi u mundësua lobimi për mbështetje politike dhe koordinim ndër-institucional në vijim të procesit të buxhetimit lokal në Këshillin Bashkiak Elbasan. Objektivi specifik ishte paraqitja e çështjeve të lagjes “Rrapishtë” përballë përfaqësuesve të këshillit bashkiak në takim dhe kërkesa drejtuar atyre që të llojnë që prioritetet të përfshihen në buxhetin e vitit 2026, në mënyrë që zëri i komunitetit të dëgjohet dhe të reflektohet në vendimmarrje. Ndër të tjera, synimi ishte edhe

forcimi i bashkëpunimit midis përfaqësuesve të komunitetit dhe institucioneve lokale dhe integrimi i nevojave të lagjes në procesin e vendimmarrjes publike.

Takimi advokues bashkoi anëtarët e Këshillit Bashkiak Elbasan nga parti të ndryshme, drejtuesit dhe ekspertët e LRER, Grupin e Advokimit komunitar të lagjes “Rrapishtë” dhe anëtarët e komunitetit. Ky format kontribuoi në një atmosferë ku të gjitha palët patën mundësinë të shfaqin prioritete dhe shqetësime në mënyrë të strukturuar.

Ervis Çota, drejtuesi i LRER, që drejtoi takimin, bëri një prezantim të qartë të rolit dhe historisë së përfaqësimit të komunitetit, duke i vendosur problemet e lagjes në kontekstin e buxhetimit me pjesëmarrje. Qasja komunikative u fokusua në pasqyrimin e çështjeve të identifikuara si pjesë e një procesi të vazhdueshëm konsultimi publik.

Diskutimet u përqendruan në prioritete të qarta të komunitetit: asfaltimi, ndriçimi, kanalizimet si dhe çështjet e pengesave të lëvizjes së banorëve për shkak të përmytjeve të lagjes gjatë reshjeve. Gjithashtu, u vlerësua rëndësia e transparencës dhe qasjes në informacion, përfshirja e të dhënave nga pyetësorët si instrument i besueshëm për ndikim në vendimmarrje.

Në komunikimin me autoritetet, theksi u vendos tek ligjshmëria dhe zbatimi i procedurave të buxhetimit me pjesëmarrje.

Pjesëmarrësit institucionalë shfaqën mbështetje për dëgjimin e zërave të komunitetit dhe për të gjetur mënyra për të integruar prioritetet në diskutimet për buxhetin. Përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak u treguan të gatshëm për të lobuar dhe për të përfshirë çështje si rrugët, ndriçimi dhe infrastruktura në planifikimin buxhetor për vitin 2026. Banorët shprehën një nevojë të qartë për një zë të vazhdueshëm dhe për përmirësimin e besimit tek institucionet publike, duke theksuar nevojën për veprime konkrete dhe një rrugë të qartë për monitorimin e procesit.

Sfida kryesore ishte mungesa e besimit nga ana e banorëve për realizimin e projekteve dhe mungesa e transparencës në komunikim dhe aksesin në të dhëna. Mundësitë përmes kësaj praktike përfshijnë vazhdimin e dialogut me mbështetjen e LRER-së, përdorimin e mbledhjeve për buxhetimin me pjesëmarrje si platformë të qëndrueshme, dhe aplikimin për programe të tjera bashkëfinansimi në nivel qendror. Ky këndvështrim tregon se, edhe pse ekzistojnë barrierat, ekziston edhe një rrugë e qartë drejt progresit nëpërmjet angazhimit institucional dhe një administrimi transparent.

Praktika 8: Përdorimi i peticionit si mekanizëm ligjor për të ndikuar në vendimmarrje

Praktika 8 inkurajon përdorimin e një instrumenti të njohur dhe të efektshëm të advokimit komunitar si peticioni me mbështetje të gjerë nga komuniteti. Objektivi kryesor është të shfaqet në mënyrë të qartë dhe të matshme mbështetja publike për prioritetet e lagjes “Rrapishtë” dhe për kërkesat konkrete të buxhetimit për vitin 2026. Peticioni krijon një sinjal të fuqishëm të nevojës urgjente të veprimeve nga institucionet vendore dhe rrit besueshmërinë e kërkesave, duke i dhënë një bazë ankese të mbështetur nga të dhënat reale të zërit qytetar dhe të shoqërisë civile.

Ky peticion u regjistrua në regjistrin e brendshëm të peticioneve dhe iniciativave qytetare të Bashkisë Elbasan dhe u dokumentua në regjistrin elektronik me emërtimin ”Kërkesë për

përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve të lagjes Rrapishtë”, me kod regjistrimi P5, me numër protokoll 2422, më datë 10.12.2025, dhe duke regjistruar Banorët e lagjes Rrapishtë si grupi që bëri peticionin (https://docs.google.com/spreadsheets/d/e/2PACX-1vTQz1_XfsqZyfy-m5Yne_5boGZzVIu_HObwqEfpKByn8t6uYsvLTx7KwU_ZQP4wRFx8wZ7StWOT3xn/pubhtml?gid=0&single=true)

Përmes një peticioni të mirë-strukturuar, komuniteti mund të shprehë zërin e tij në mënyrë të bashkuar dhe koherente. Ky mjet lejon konsolidimin e mendimeve dhe të dëshmimeve nga banorët në një dokument të qartë që përmbledh të dhënat nga pyetësorët, pohime dhe deklarata nga banorët mbi pyetjet e hapura, dhe prioritetet kryesore të lagjes. Pyetësi ofron në të njëjtën kohë mbështetjen publike për paketën e prioriteteteve të lagjes dhe krijon një kontur të qëndrueshëm të angazhimit komunitar me institucionet. Në këtë mënyrë, peticioni vepron si një mekanizëm ligjor, i cili mund të drejtojë vëmendjen institucionale dhe të ketë ndikim mbi vendimmarrjen buxhetore.

Strategjia e përdorimit të peticionit përfshin një fazë planifikimi të kujdesshëm ku identifikohen qëllimet specifike dhe parashtrihen kërkesa të qarta. Ajo konsiston në:

- Krijimin e një drafti të peticionit që përmbledh qartë çështjet (asfaltimi, ndriçimi, kanalizimet) dhe një kërkesë konkrete për kalim buxhetor për vitin 2026.

- Mbështetjen nga komuniteti përmes nënshkrimeve të besueshme nga një grup i gjerë banorësh të lagjes “Rrapishtë”.

- Dorëzimin zyrtar të peticionit.

- Ndjekjen dhe monitorimin e përgjigjeve institucionale.

Ky peticion mori përgjigje zyrtare brenda afatit, me shkresë me numër protokoll 2422/1, më datë 19.01.2026. Kthimi i përgjigjes pranon kërkesën për sistemimin e rrugës, mungesën e kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ndriçimit në lagjen Rrapisht dhe deklaroi se kërkesa do të merret në konsideratë.

Nëse menaxhohet me kujdes, peticioni mund të sjellë një dëshmi të fuqishme të mbështetjes qytetare, të nxjerrë në plan të parë prioritetet dhe të krijojë një mekanizëm monitorimi për zbatimin e rekomandimeve të lagjes “Rrapishtë”. Ai bën kalimin nga njoftimi te veprimi dhe edukon banorët mbi të drejtat qytetare dhe përgjegjësinë institucionale. Përmes këtij procesi, peticioni bëhet një mjet për të forcuar besimin midis komunitetit dhe qeverisjes publike dhe për të çuar përpara një dialog konstruktiv përmes të cilit vendimet të merren me një konsensus të gjerë.

Praktika 9: Lobimi si mjet për ndikim në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak

Për të arritur pjesëmarrje dhe përfaqësim në procesin e miratimit të buxhetit për vitin 2026, u realizua një komunikim lobues përmes email-it zyrtar dërguar 51 anëtarëve të Këshillit Bashkiak Elbasan, përfaqësuesve të të gjitha subjekteve politike. Praktika 9 synon të influencojë drejtpërdrejt alokimin e burimeve për lagjen “Rrapishtë” në buxhetin e vitit 2026 përmes një

kanali të strukturuar komunikimi me përfaqësuesit politikë të Këshillit Bashkiak Elbasan. Objektivi është të sigurohet një mbështetje më e gjerë politike dhe procedurale për propozimet konkrete të lagjes, duke përdorur një formë masive dhe të disponueshme të komunikimit, si e-maili zyrtar, për të siguruar dokumentimin, transparencën dhe një reagim të matur nga institucionet. Kjo praktikë synon të konsolidojë zërin e komunitetit në hapësirën publike të buxhetimit dhe të nxisë një reagim të shpejtë dhe të matshëm nga të gjitha palët politike.

Në këtë praktikë, emaili zyrtar shërben si një mjet i qartë dhe i verifikueshëm komunikimi me institucionet. Kjo praktike pozitive synon të shmangë ankesat dhe të sigurojë që zëri i komunitetit të shndërrohet në propozime të monitorueshme, transparente dhe me afate të qarta.

Struktura e komunikimit dhe përmbajtja e emailit

Pas reagimit të procesit të BP, nevojitet të mbaheshin në vëmendje prioritetet dhe pritshmëritë nga buxheti 2026. Bazuar në nevojat e identifikuara dhe konsultimet me banorët, kërkesat kryesore përfshijnë:

- asfaltimin dhe ndriçimin e rrugëve të lagjes;
- përmirësimin e sistemit të kanalizimeve;
- ndërhyrje të qëndrueshme për zhvillimin e përgjithshëm infrastrukturor të zonës.

Rreziku dhe etika publike

Është thelbësore të mbrohet integriteti i procesit dhe të shmangen keqinterpretimet. Kjo përfshin: transparencën e plotë të mënyrës së dërgimit të email-it, saktësinë e të dhënave të paraqitura, dhe sigurimin që të gjitha propozimet janë të bazuara në të dhëna të bazuara në komunitet. Gjithashtu, është e nevojshme të respektohet një procedurë e barabartë për të gjitha palët politike, duke siguruar një qasje të drejtë dhe të hollësishme ndaj buxhetit të vitit 2026.

Praktika 10: Mekanizmi i dialogut të vazhdueshëm për llogaridhënie dhe transparencë

Praktika që lidhet me ndërtimin e dialogut të vazhdueshëm për llogaridhënie synon të krijojë dhe të mbështesë një mekanizëm të qëndrueshëm dialogu me autoritetet vendore në mënyrë që vendimmarrja të jetë e ndjekur nga llogaridhënia dhe transparenca. Objektivi kryesor është të sigurohet një komunikim i rregullt dhe i strukturuar midis komunitetit, grupit të advokimit dhe institucioneve publike. Ky proces synon të forcojë besimin ndërmjet palëve dhe të nxisë implementimin e veprimeve me afate të qarta.

Mbushja e boshllëkut të komunikimit institucional, në kuadër të këtij projekti, u realizua hap pas hapi, duke filluar me dokumentin e kërkesave prioritare dhe duke vijuar me të gjitha praktikat e përmendura në këtë seksion. Dialogu do të vijojë edhe me prezantimin e gjetjeve të raportit studimor, dhe synohet të qëndrojë aktiv në vazhdimësi, edhe pas përfundimit të projektit.

Ndërmjet kësaj qasjeje, dialogu synon të zhvillohet në një hapësirë të mirërregulluar dhe të kontrolluar, me takime periodike të planifikuara me autoritetet vendore (bashkia, këshilli bashkiak) dhe anëtarët e komunitetit të lagjes “Rrapishtë”. Çdo takim duhet të fokusohet në

vlerësimin e progresit, identifikimin e pengesave dhe rivlerësimin e prioriteteve, duke siguruar një gjurmë të dokumentuar të të gjitha diskutimeve dhe vendimeve.

Ky mekanizëm synon të sigurojë një platformë të vazhdueshme të llogaridhënies publike: ndër të tjera, transparencën e përditësuar, qasjen në informacion, dhe një mekanizëm të monitorimit të mbarëvajtjes së projekteve. Pjesëmarrja aktive e komunitetit në mënyrë periodike rrit përgjegjshmërinë e institucioneve për të arritur rezultate konkrete dhe për të adresuar shqetësimet në kohë të duhur. Me vite, kjo praktikë pozitive dialogu mund të kontribuojë në një kulturë vendimmarrjeje ku komunikimi i qartë dhe raportimet e rregullta bëhen pjesë e jetës institucionale dhe të marrëdhënieve me qytetarët.

Nëse ky dialog vazhdon në mënyrë të strukturuar, pritet që Bashkia dhe institucionet përkatëse të japin përgjigje të dukshme dhe të matshme për ankesat dhe prioritetet e komunitetit. Kështu mund të arrihet një nivel i lartë i besimit publik dhe një përmirësim në integrimin e nevojave të lagjes “Rrapishtë” në procedurat e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit.

Praktika 11: Takim teknik për implementimin e prioriteteve të komunitetit me përfaqësuesit e bashkisë

Praktika 11 ka për qëllim të forcojë një diskutim të fokusuar dhe teknik në lidhje me zbatimin e kërkesave të komunitetit për lagjen “Rrapishtë” përmes një takimi të drejtpërdrejtë në zyrën e zv. kryetarit të Bashkisë. Objektivi kryesor është të shfrytëzohen kanalet administrative dhe institucionale për të shpjeguar prioritetet, për të nxjerrë konkluzione konkrete dhe për të përcaktuar afatet dhe përgjegjësit për implementimin e projekteve infrastrukturore. Ky takim synon të fuqizojë bashkëpunimin mes LRER-së, Grupit të Advokimit dhe administratës lokale duke krijuar një rrugë të qartë llogaridhënieje dhe një plan veprimi të realizueshëm.

Takimi u zhvillua në një kontekst zyrtar në zyrën e zv/kryetarit të bashkisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të LRER dhe të Grupit të Advokimit Komunitar të lagjes “Rrapishtë”. Ai shërbeu si një platformë ndërmjetësimi e qartë midis kërkesave të komunitetit dhe kufizimeve buxhetore dhe operacionale të Bashkisë, duke siguruar dokumentimin e hollësishëm të diskutimeve dhe vendimeve të marra.

Qëllimi kryesor i takimit ishte krijimi i një bërthame të fortë bashkëpunimi midis LRER, Grupit të Advokimit dhe institucioneve vendore. Ky mekanizëm siguron një kanal të drejtë dhe të verifikueshëm për diskutimin dhe monitorimin e zbatimit të projekteve në lagjen “Rrapishtë”. Njohja e qartë e çështjeve teknike dhe monitorimi i zbatimit të tyre mund të rrisë shpejtësinë e vendimmarrjes dhe të forcojë besimin e komunitetit në proceset vendimmarrëse.

Praktika 12: Përdorimi i multimedias dhe rrjeteve sociale si mjet për ndërgjegjësim publik dhe presion pozitiv

Praktika 12 synon të rrisë vizibilitetin dhe transparencën e kërkesave të komunitetit të lagjes “Rrapishtë” duke shfrytëzuar teknologjitë e medias dhe rrjetet sociale. Qëllimi kryesor është të konsolidohet presioni publik në një mënyrë të mbështetur me të dhëna dhe të ofrohet një realitet i qartë për publikun dhe institucionet, duke nxitur një përgjigje të shpejtë dhe të monitorueshme nga ana e Bashkisë dhe organeve të tjera vendore. Përdorimi i multimedias lejon përçimin e

informacioneve në formate të lehta për t'u kuptuar, duke përmirësuar aksesin në të dhëna dhe duke forcuar pjesëmarrjen e komunitetit në proceset vendimmarrëse.

Në këtë praktikë, përmes krijimit dhe shpërndarjes së materialeve multimediale (video, foto, tekst), komuniteti dhe grupi i advokimit paraqesin problemet dhe prioritetet e lagjes “Rrapishtë” në një mënyrë që mbështetet nga të dhënat dhe dëshmitë nga terreni. Kjo qasje synon të mbajë një linjë të hapur të komunikimit me publikun.

Struktura e përgatitjes dhe përmbajtja e materialeve

- Prodhimi i videove të shkurtra (1–2 minuta) që ilustrojnë problemet kryesore (asfaltimi, ndriçimi, kanalizimet) dhe nevojat e lagjes.
- Fotografitë dokumentuese nga vendngjarjet/rrugët problematike dhe dëshmi nga banorët.
- Tekste të shkurtra shpjeguese me fakte dhe të dhëna të mbledhura (nga pyetësorët, procesverbalet, dhe peticionet).
- Një plan shpërndarjeje në rrjete sociale (Facebook i LRER) dhe një plan moderimi të komenteve për të ruajtur një dialog të sigurt dhe konstruktiv.

Rregullat e etikës dhe transparenca

Është thelbësore të mbrohet integriteti i informacionit dhe të shmangen keqinterpretimet ose manipulimet. Kjo përfshin:

- etiketimin e saktë të burimeve dhe datave të publikimit,
- sqarimin e kontekstit,
- respektimin e privatësisë së banorëve dhe të të drejtave të tyre për të pranuar ose refuzuar pjesëmarrjen në materialet publike,
- shmangien e detajeve të tepruara që mund të shkaktojnë frikë ose panik të pavërtetë.

Rreziqet dhe masat e parandalimit

Ndër rreziqet kryesore janë keqinterpretimet, keqdashja në përhapjen e një mesazhi dhe mundësia e sulmeve ndaj individëve. Për të minimizuar këto rreziqe, do të sigurohen:

- miratimi paraprak i një plani të publikuar të shpërndarjes, me udhëzime për tonin, shprehjen dhe përmbajtjen e materialeve,
- një proces verifikimi të të dhënave para publikimit (burimet, data, konteksti),
- një standard i përditësimit të informacioneve dhe një mekanizëm për korrigjimin e gabimeve në postime të shpërndara

Konkluzion

Këto 12 praktika të mira paraqesin një qasje të integruar për të pasur ndikim në qeverisjen lokale dhe përmirësuar cilësinë e jetesës në lagjen “Rrapishtë”, Elbasan. Theksi kryesor është vendosur mbi përfshirjen qytetare, transparencën dhe llogaridhënien, duke i dhënë komunitetit një rol aktiv dhe të strukturuar në proceset vendimmarrëse. Kjo qasje nuk është thjesht instrumentale; ajo synon të krijojë kapacitete të qëndrueshme brenda komunitetit, të forcojë lidhjet mes aktorëve lokalë dhe të zhvillojë një kulturë dialogu konstruktiv që mund të riprodhohet edhe në kontekste të tjera.

Zinxhiri logjik i praktikave filloi me identifikimin e nevojave dhe forcimin e kapaciteteve të komunitetit (Praktikat 1–3). Ky hap është thelbësor sepse krijon një bazë empirike dhe realiste për vendimmarrje, duke u siguruar që kërkesat e komunitetit nuk bazohen vetëm në perceptime subjektive, por në të dhëna të dokumentuara dhe analizë sistematike. Përmes këtyre praktikave, komuniteti zhvilloi aftësi për vlerësimin e prioriteteve, artikulimin e kërkesave të tyre dhe përgatitjen për dialog institucional, duke krijuar një strukturë të qëndrueshme për pjesëmarrje aktive.

Më pas, dokumentimi dhe formalizimi i kërkesave (Praktikat 4–5) siguroi që zëri i komunitetit të ishte i strukturuar dhe i njohur nga autoritetet vendore. Kjo fazë e ndërthuri formalizimin e informacionit me instrumente zyrtare si dokumente të protokolluara, pyetësorë të pilotuar dhe prioritete të qarta për t’u paraqitur në institucionet vendore. Ajo shërbeu si një urë ndërmjet komunitetit dhe administratës, duke reduktuar rrezikun e keqkuptimeve, vonesave dhe mungesës së zbatimit.

Një tjetër dimension kritik ishte mobilizimi i komunitetit përmes advokimit dhe lobimit (Praktikat 6–9). Këto hapa e lehtësuan ndarjen e qartë të përgjegjësisë dhe forcimin e kanaleve të ndikimit politik dhe institucional, duke i mundësuar komunitetit të ndikojë në alokimin e burimeve, miratimin e projekteve dhe vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak. Praktikat e ndryshme, përfshirë takimet formale, email-et të strukturuar, peticionet dhe lobimin, kontribuan në sistemimin e kërkesave dhe rritjen e presionit institucional në mënyrë transparente dhe legjitime.

Më pas, praktikat vijuan me dialogun institucional dhe takimin teknik (Praktikat 10–11). Dialogu i vazhdueshëm mundësoi identifikimin e pengesave operacionale dhe burokratike, ndërkohë që mekanizmat e raportimit në brendësi të takimit teknik siguruan që përfaqësuesit e komuniteti të kishin informacion të qartë mbi progresin dhe vështirësitë në zbatim.

Në fund, komunikimi publik dhe përdorimi i mediave dhe rrjeteve sociale (Praktika 12) luajtën një rol të rëndësishëm në shtrirjen e ndikimit të praktikave përtej institucioneve, duke siguruar ndërgjegjësim të gjerë, presion publik pozitiv dhe transparencë të vazhdueshme. Kjo pjesë përforcon lidhjen midis komunitetit dhe institucioneve dhe mund të shërbejë si një model komunikimi për projekte të tjera në Elbasan dhe më gjerë.

Një qasje e qartë, koherente dhe e monitorueshme, e mbështetur nga dialogu, transparenca dhe llogaridhënia, krijon një kulturë të qëndrueshme bashkëpunimi dhe mund të shtrihet edhe në komunitete të tjera, duke rritur efektivitetin e qeverisjes lokale dhe integritetin institucional në tërësi. Ky proces nuk përmirëson vetëm shërbimet infrastrukturore dhe pjesëmarrjen qytetare, por edhe kapacitetet institucionale për të reaguar ndaj nevojave të komunitetit në mënyrë të drejtë dhe transparente, duke krijuar një model të qëndrueshëm zhvillimi lokal.

KREU V. REKOMANDIME

Rekomandimet e paraqitura në këtë kapitull përbëjnë një hapësirë të integruar ndërhyrjeje, e cila ndërthur në mënyrë koherente gjetjet kryesore të Raportit Studimor, Raportit të Monitorimit dhe analizën e 12 Praktikave të Mira të identifikuara gjatë zbatimit të ndërhyrjeve në lagjen Rrapishtë të Elbasanit. Kjo hapësirë synon t'i përgjigjet drejtpërdrejt nevojave reale, kapaciteteve ekzistuese dhe sfidave strukturore me të cilat përballen komunitetet Rome dhe Egjiptiane, duke vendosur pjesëmarrjen qytetare dhe drejtësinë sociale në qendër të qeverisjes vendore.

Në thelb, rekomandimet synojnë të forcojnë lidhjen midis institucioneve vendore dhe komunitetit, të rrisin besueshmërinë e proceseve vendimmarrëse dhe të sigurojnë që politikatat publike, veçanërisht ato që lidhen me buxhetimin me pjesëmarrje, të reflektojnë në mënyrë të drejtë dhe gjithëpërfshirëse zërin e grupeve të marginalizuara.

1. Forcimi i mekanizmave të përfshirjes së komunitetit

Forcimi i mekanizmave të përfshirjes së komunitetit përbën një nga shtyllat kryesore të qeverisjes gjithëpërfshirëse dhe një parakusht për funksionimin efektiv të buxhetimit me pjesëmarrje. Gjetjet e raportit tregojnë se mungesa e mekanizmave të strukturuar dhe të vazhdueshëm të komunikimit midis institucioneve dhe banorëve të lagjes Rrapishtë kufizon pjesëmarrjen aktive dhe kontribuon në një ndjenjë përjashtimi institucional, veçanërisht për komunitetet Romë dhe Egjiptiane.

Një mekanizëm i qartë dhe i aksesueshëm përfshirjeje, duhet të shërbejë si një hapësirë e rregullt dialogu ku komuniteti informohet, konsultohet dhe ftohet të kontribuojë në mënyrë aktive në proceset vendimmarrëse. Dialogu i hapur dhe i vazhdueshëm jo vetëm që rrit transparencën, por gjithashtu ndërton besim reciprok dhe krijon mundësi reale për integrimin e perspektivave të ndryshme në politikatat lokale.

Pa një mekanizëm të tillë, nevojat dhe prioritetet e komunitetit rrezikojnë të mbeten të pashprehura ose të mos përkthehen në vendime konkrete, duke thelluar pabarazitë ekzistuese. Efekti i pritshëm i këtij rekomandimi është rritja e pjesëmarrjes qytetare dhe përmirësimi i cilësisë së vendimmarrjes me përfshirjen e qytetarëve në nivel lokal.

2. Planifikim i përshtatur me aftësitë, nevojat dhe oraret e komunitetit

Një planifikim efektiv dhe gjithëpërfshirës kërkon që proceset konsultative të jenë të përshtatura me realitetin social, kulturor dhe ekonomik të komunitetit. Analiza e të dhënave tregon se konsultimet standarde, të zhvilluara pa marrë parasysh barrierat social-kulturore dhe kohore, kufizojnë ndjeshëm pjesëmarrjen e komuniteteve Romë dhe Egjiptiane dhe krijojnë një hendek midis politikëbërjes dhe nevojave reale në terren.

Për këtë arsye, rekomandohet që mjetet dhe format e konsultimit të adaptohen në mënyrë fleksibël, duke përfshirë përdorimin e gjuhës së kuptueshme, ndërmjetësve komunitarë, orareve të përshtatshme dhe formateve joformale të dialogut. Përfshirja e komunitetit në të gjitha fazat e ciklit të planifikimit, nga identifikimi i nevojave deri te monitorimi i zbatimit, është thelbësore

për të siguruar që investimet publike të reflektojnë prioritetet reale dhe të kenë ndikim të qëndrueshëm.

Efekti i pritshëm është zhvillimi i politikave më të drejta dhe më efektive, reduktimi i barrierave strukturore për pjesëmarrje dhe rritja e besimit të komunitetit ndaj institucioneve publike.

3. Transparenca, llogaridhënia dhe besueshmëria në vendimmarrje

Transparenca dhe llogaridhënia përbëjnë elementë thelbësorë për ndërtimin e besueshmërisë institucionale dhe për garantimin e një pjesëmarrjeje kuptimplote të komunitetit. Gjetjet e raportit tregojnë se mungesa e informacionit të qartë mbi mënyrën se si merren vendimet dhe si përdoren fondet publike krijon konfuzion, keqkuptime dhe skepticizëm ndaj proceseve vendimmarrëse.

Rekomandohet krijimi i mekanizmave të qartë të llogaridhënies publike, ku komuniteti informohet në mënyrë të rregullt dhe brenda afateve të përcaktuara për ecurinë e projekteve dhe për mënyrën se si sugjerimet dhe prioritetet e tyre janë reflektuar në vendime konkrete. Një transparencë e tillë jo vetëm që rrit përgjegjshmërinë institucionale, por gjithashtu forcon ndjenjën e pronësisë së komunitetit mbi proceset zhvillimore.

Efektet e pritura përfshijnë rritjen e besimit publik, përmirësimin e performancës së shërbimeve publike dhe krijimin e një kulture të qëndrueshme llogaridhënieje në nivel lokal.

4. Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të komunitetit

Fuqizimi i kapaciteteve të komunitetit për advokim dhe dialog me institucionet është një kusht thelbësor për një pjesëmarrje të barabartë dhe efektive. Gjetjet tregojnë se mungesa e njohurive dhe aftësive teknike kufizon aftësinë e komunitetit për të artikuluar kërkesat e tyre dhe për të ndikuar në vendimmarrje.

Ndërhyrjet për ngritjen e kapaciteteve duhet të fokusohen në trajnime për advokim komunitar, komunikim efektiv me institucionet dhe menaxhim të të dhënave që lidhen me buxhetimin me pjesëmarrje. Një rol i rëndësishëm i takon gjithashtu krijimit dhe forcimit të rrjeteve mbështetëse, ku shoqëria civile, aktorët lokalë dhe liderët komunitarë bashkëpunojnë për të fuqizuar dhe përcjellë zërin e komunitetit.

Efekti i pritshëm është transformimi i komunitetit nga një përfitues pasiv në një faktor aktiv dhe të barabartë në dialogun publik, duke kontribuar në një zhvillim lokal më të drejtë dhe të qëndrueshëm.

5. Përmirësimi i informimit të komunitetit

Informimi i rregullt dhe i aksesueshëm përbën bazën e çdo procesi pjesëmarrës. Mungesa e informacionit të qartë dhe të kuptueshëm mbi buxhetimin me pjesëmarrje dhe mundësitë për përfshirje kufizon ndjeshëm kontributin e komunitetit dhe rrit rrezikun e keqinformimit.

Rekomandohet zhvillimi dhe shpërndarja e materialeve informuese të përshtatura për komunitetin, përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, si dhe organizimi i sesioneve informuese të rregullta në nivel lagjeje. Këto ndërhyrje duhet të fokusohen jo vetëm në shpërndarjen e informacionit, por edhe në krijimin e hapësirave për diskutim dhe reflektim kolektiv.

Efekti i pritshëm është rritja e njohurive mbi proceset vendimmarrëse, rritja e pjesëmarrjes në konsultime publike dhe fuqizimi i komunitetit si një zë aktiv në zhvillimin lokal.



LËVIZJA RINORE EGJIPTIANE DHE ROME
